



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2024

PËR

PERFORMANCËN ENERJITIKE TË NDËRTESAVE¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

**KREU I
PARIME TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim promovimin dhe përmirësimin e performancës energjitime të ndërtesave dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë të shkaktuara nga stoku i ndërtesave në Republikën e Shqipërisë, duke konsideruar kushtet klimatike të jashtme, kushtet lokale, kërkesat për cilësinë e mjedisit të brendshëm, nivelin optimal të kostos duke synuar një stok ndërtesash pa emetime deri në vitin 2050.

**Neni 2
Objekti**

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e:

- kuadrit të përgjithshëm për metodologjinë kombëtare të llogaritjes së integruar të performancës energjitime të ndërtesave dhe të njësive të ndërtesave;
- kërkesave minimale për performancën energjitime të ndërtesave të reja dhe të njësive të ndërtesave të reja;
- Kërkesave minimale për:

¹“Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Direktivën (BE) 2024/1275 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 Prill 2024 “Për Performancën Energjitime të Ndërtesave”. Numri CELEX 32024L1275, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, datë 8.5.2024”

- i. ndërtesat ekzistuese dhe njësitë e ndërtesave ekzistuese që do ti nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm;
 - ii. elementet e ndërtesës që përbëjnë pjesë të mbështjellëses së ndërtesës dhe që kanë një ndikim të konsiderueshëm në performancën energjitime të mbështjellëses së ndërtesës kur ato rinovohen ose zëvendësohen;
 - iii. sistemet teknike të ndërtesave, kur ato instalohen, zëvendësohen ose përmirësohen;
 - iv. kushtet e mjedisit të brendshëm të ndërtesave, për të garantuar kushtet e komfortit dhe mirëqënjes për përdoruesit.
- ç) standardeve të performancës energjitime të ndërtesave për ndërtesa ekzistuese dhe njësi të ndërtesave ekzistuese në përputhje me nenin 5 dhe 6;
 - d) metodës së llogaritjes dhe identifikimit të potencialit të ngrohjes globale (PNG) përgjatë ciklit jetësor të ndërtesës;
 - dh) kërkesave për shfrytëzimin e energjisë diellore në ndërtesa;
 - e) kërkesave për librezën e rinovimit të ndërtesës;
 - ë) planit kombëtar për rinovimin e ndërtesave dhe rritjen e numrit të ndërtesave pa emetime;
 - f) kërkesave për infrastrukturë të qëndrueshme për lëvizshmërinë, në afërsi të ndërtesave ose brenda tyre;
 - g) kërkesave për ndërtesat inteligjente;
 - gj) kërkesave për certifikimin e performancës energjitime të ndërtesave dhe të njërive të ndërtesave;
 - h) kërkesave për inspektimin në mënyrë periodike të sistemeve të ngrohjes, sistemeve të ventilimit dhe sistemeve të kondicionimit të ajrit në ndërtesa;
 - i) kërkesave për krijimin e një sistemi të pavarur për kontrollin e certifikatave të performancës energjitime, librezave të rinovimit dhe raporteve të inspektimit të sistemeve teknike;
 - j) Performancën e cilësisë së mjedisit brenda ndërtesave.

Neni 3 Fusha e zbatimit

1. Ky ligj do të zbatohet për të gjitha ndërtesat e reja dhe ndërtesat që do t'i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm që nga faza e projektimit deri në pajisjen me leje shfrytëzimi sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit si dhe për të gjithë ndërtesat ekzistuese të stokut kombëtar.
2. Kategoritë e ndërtesave që përjashtohen plotësisht ose pjesërisht nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për zhvillimin urban.

Neni 4 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Cilësia e ambientit/mjedisit të brendshëm”** është rezultati i vlerësimit të kushteve brenda një ndërtese që ndikojnë në shëndetin dhe mirëqenien e banorëve të saj, bazuar në parametra të tillë si ato që kanë të bëjnë me temperaturën, lagështinë, shkallën e **ventilimit** dhe praninë e ndotësve.

2. **“Energji e eksportuar”** do të thotë përqindja e energjisë së rinovueshme, e shprehur për bartës energjetik dhe për faktorin e energjisw primare, që eksportohet në rrjetin e elektroenergjetik në vend që të përdoret në vend për vetëpërdorim ose për përdorime të tjera në vend;
3. **“Energji e shpërndarë”** nënkupton energjinë, e shprehur për bartës energjetik, e furnizuar në sistemet teknike të ndërtesës përmes kufirit të vlerësimit, për të përmbushur përdorimet e marra në konsideratë ose për të prodhuar energjinë e eksportuar;
4. **“Energji nga burimet e rinovueshme të prodhuara pranë”** nënkupton energjinë nga burimet e rinovueshme, të prodhuara brenda një perimetri në nivel lokal ose rrethi të një ndërtese të caktuar, e cila plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a) mund të shpërndahet dhe përdoret vetëm brenda atij perimetri të nivelit lokal dhe qarkut nëpërmjet një rrjeti të dedikuar shpërndarjeje;
 - b) lejon llogaritjen e një faktori specifik të energjisë primare të vlefshme vetëm për energjinë nga burimet e rinovueshme të prodhuara brenda atij perimetri të nivelit lokal ose qarkut; dhe
 - c) mund të përdoret në vendodhje nëpërmjet një lidhjeje të dedikuar me burimin e prodhimit të energjisë, ku kjo lidhje e dedikuar kërkon pajisje specifike për furnizimin dhe matjen e sigurt të energjisë për vetëpërdorim të ndërtesës;
5. **“Familje të cenueshme”** janë familje që jetojnë në varfëri energjitike ose familje, (duke përfshirë familjet me të ardhura mesatare më të ulëta), të cilat janë veçanërisht të ekspozuara ndaj kostove të larta të energjisë dhe të cilave u mungojnë mjetet financiare për të rinovuar ndërtesën në të cilën jetojnë;
6. **“Gjenerator nxehtësie”** është pjesa e një sistemi ngrohjeje që gjeneron nxehtësi të dobishme për përdorimet e identifikuar në Nenin 8, duke përdorur një ose më shumë nga proceset e mëposhtme:
 - a) djegia e lëndëve djegëse, për shembull, në një kaldajë;
 - b) efektin “Joule”, që ndodh në elementet ngrohëse të një sistemi ngrohjeje me rezistencë elektrike;
 - c) marrjen e nxehtësisë nga ajri i ambientit, ajri i larguar përmes ventilimit ose përmes një burim nxehtësie (uji ose tokës) nëpërmjet përdorimit të një pompë nxehtësie;
7. **“Hapësirë parkimi për biçikleta”** nënkupton një hapësirë të caktuar për parkimin e të paktën një biçiklete;
8. **“Impiant ftohës”** është pjesë një sistemi klimatizimi që largon nxehtësinë duke gjeneruar ftohje të dobishme për përdorimet e identifikuar në Nenin 8;
9. **“Instalime elektrike paraprake”** përfshijnë të gjitha masat e nevojshme që mundësojnë instalimin e pikave të karikimit, duke përfshirë transmetimin e të dhënave, kabllot, rrugët kabllore dhe kur është e nevojshme, matësit e energjisë elektrike;
10. **“Kaldajë”** është kombinim këmbyesit të nxehtësisë me djegësin i projektuar për të transmetuar nxehtësinë që çlirohet nga procesi i djegies tek fluidët ose bartësit e energjisë.
11. **“Karikimi inteligjent”** nënkupton një operacion rimbushjeje në të cilin intensiteti i energjisë elektrike që i dërgohet baterisë rregullohet në kohë reale, bazuar në informacionin e marrë nëpërmjet komunikimit elektronik;
12. **“Karikimi me dy drejtime”** nënkupton një operacion rimbushjeje inteligjente ku kahu i energjisë elektrike mund të ndryshohet, duke lejuar që energjia elektrike të kalojë nga bateria në pikën e rimbushjes me të cilën është lidhur;
13. **“Kontraktimi i performancës energjitike”** nënkupton një marrëveshje kontraktuale ndërmjet përfituesit dhe ofruesit të një mase për përmirësimin e efikasitetit energjitike, e verifikuar dhe monitoruar gjatë gjithë afatit të kontratës, ku punët, furnizimi ose shërbimi në atë masë paguhet në lidhje me një nivel të dakordësuar të përmirësimit të efikasitetit energjitike ose një kriter tjetër i dakordësuar i performancës energjitike, siç janë kursimet

financiare;

14. **“Kufitë e vlerësimit”** është kufiri ku matet ose llogaritet energjia e konsumuar dhe energjia e eksportuar;
15. **“Nevoja për energji”** nënkupton energjinë që do ti jepet ose do të merret nga një hapësirë e kondicionuar për të ruajtur kushtet e synuara të hapsirës gjatë një periudhe të caktuar kohore, pa marrë parasysh mosefikasitetin e sistemit teknik të ndërtesës;
16. **“Në vendodhje”** do të thotë brenda ose në një ndërtesë të caktuar ose në tokën në të cilën ndodhet ajo ndërtesë;
17. **“Parking fizikisht ngjitur me ndërtesën”** nënkupton parkimin e makinave i cili është i destinuar për shfrytëzimin e banorëve, vizitorëve ose punëtorëve të një ndërtese dhe që ndodhet brenda zonës pronësore të ndërtesës ose është në afërsi të drejtpërdrejtë të ndërtesës;
18. **“Përdorim i energjisë”** ose “konsumi i energjisë” nënkupton hyrjen e energjisë në sistemin teknik të ndërtesës që ofron një shërbim PEN që synon të plotësojë një nevojë për energji;
19. **“Përdorime të tjera në vendodhje”** do të thotë përdorime në vendodhje, përveç shërbimeve PEN, duke përfshirë pajisjet, ngarkesat e ndryshme dhe ndihmëse, ose pikat e karikimit të makinave elektrike;
20. **“Pikë karikimi”** nënkupton një platformë fikse ose të lëvizshme, të lidhur me rrjeti ose jo për transferimin e energjisë elektrike në një automjet elektrik, i cili, megjithëse mund të ketë një ose më shumë konektorë për të akomoduar lloje të ndryshme konektorësh, është në gjendje të karikojë vetëm një automjet elektrik në të njëjtën kohë dhe që përjashton pajisjet me fuqi dalëse më të vogël ose të barabartë me 3.7 kE, qëllimi kryesor i të cilave nuk është karikimi i automjeteve elektrike;
21. **“Regjistri digjital i ndërtesave”** nënkupton një depo të përbashkët për të gjitha të dhënat përkatëse të ndërtesës, duke përfshirë të dhënat në lidhje me performancën energjitike të tilla si certifikatat e performancës energjitike, librezat e rinovimit, si dhe të dhënat në lidhje me PNG të ciklit jetësor, të cilat lehtëson vendimmarrjen e informuar dhe shkëmbimin e informacionit brenda sektorit të ndërtimit, dhe ndërmjet pronarëve dhe banorëve të ndërtesave, institucioneve financiare dhe organeve publike;
22. **“Sipërfaqja e dobishme e dyshemesë”** do të thotë sipërfaqja e dyshemesë së një ndërtese që nevojitet si parametër për të përcaktuar sasinë e kushteve specifike të përdorimit që shprehen për njësi të sipërfaqes së dyshemesë dhe për zbatimin e thjeshtimeve dhe zonimit dhe rregullave të ndarjes ose rishpërndarjes;
23. **“Sipërfaqja referente e dyshemesë”** nënkupton sipërfaqen e dyshemesë së përdorur si madhësi referente për vlerësimin e performancës energjitike të një ndërtese, e llogaritur si shuma e sipërfaqeve të dobishme të dyshemesë së hapësirave brenda mbështjellësit të ndërtesës të specifikuara për vlerësimin e performancës energjitike;
24. **“Sistem ngrohje”** është një kombinim i komponentëve të nevojshëm për të siguruar një formë të trajtimit të ajrit të brendshëm, me anë të të cilit temperatura kontrollohet ose mund të rritet;
25. **“Skema financiare paguaj sa të kurseni”** do të thotë një skemë kredie e dedikuar ekskluzivisht për përmirësimin e performancës energjitike ku vendoset një korrelacion në hartimin e skemës midis shlyerjeve të huasë dhe kursimeve të arritura të energjisë, duke marrë gjithashtu parasysh të merren parasysh faktorë të tjerë ekonomikë si indeksimi i kostos së energjisë, normat e interesit, rritja e vlerës së aseteve dhe rifinancimi i kredisë;
26. **“Standardet e portofolit të hipotekës”** do të thotë mekanizma që stimulojnë huadhënësit hipotekorë për të krijuar një rrugë për të rritur performancën energjitike mesatare të portofolit të ndërtesave të mbuluara nga hipotekat e tyre drejt viteve 2030 dhe 2050, dhe për të inkurajuar klientët potencial për të përmirësuar performancën energjitike të pronës së tyre në përputhje me ambicien e Bashkimit për dekarbonizimin dhe objektivat përkatëse

- të energjisë në fushën e konsumit të energjisë në ndërtesa, duke u mbështetur në kriteret për përcaktimin e aktiviteteve ekonomike të qëndrueshme mjedisore të përcaktuara në nenin 3 të Rregullores (BE) 2020/852;
27. **“Standardet minimale të performancës energjitike”** janë kërkesa që duhet të plotësojnë ndërtesat ekzistuese për të arritur një nivel të performancës energjitike si pjesë e një plani të gjerë rinovimi për një stok ndërtimi ose në një pikë nxitëse në treg si shitja, qiraja, dhurimi ose ndryshimi i qëllimi brenda kadastrës ose regjistrin të tokës, në një periudhë kohore ose në një datë të caktuar, duke shkaktuar kështu rinovimin e objekteve ekzistuese;
 28. **“Shërbime të lidhura me performancën energjitike të ndërtesave”** ose **“shërbime PEN”** do të thotë shërbimet, të tilla si ngrohja, ftohja, ventilimi, uji i ngrohtë dhe ndriçimi dhe të tjera për të cilat përdorimi i energjisë merret parasysh në llogaritjen e performancës energjitike të ndërtesave;
 29. **“Vetëpërdorim”** nënkupton përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme të prodhuara në vendodhje ose të energjisë nga burimet e rinovueshme të prodhuara pranë nga sistemet teknike në vendodhje për shërbimet PEN;
 30. **“Certifikata e performancës energjitike”** është një dokument i lëshuar nga audituesi energjetik, ku përcaktohet performanca energjitike e një ndërtese ose e njësisë së një ndërtese, e përcaktuar dhe e lëshuar sipas kërkesave të këtij ligji.
 31. **“E matur”** është matja e realizuar nga një pajisje përkatëse, si një matës energjie, një matës i fuqisë, një pajisje matëse dhe monitoruese e energjisë ose një matës i energjisë elektrike;
 32. **“Element i ndërtesës”** sështë një sistem teknik i ndërtesës ose një element i mbështjelljes së ndërtesës
 33. **“Emetimet e gazeve serrë gjatë gjithë ciklit jetësor”** janë emetimet e gazeve serrë që ndodhin gjatë gjithë ciklit jetësor të një ndërtese, duke përfshirë prodhimin dhe transportin e produkteve të ndërtimit, aktivitetet në kantier, përdorimin e energjisë në ndërtesë dhe zëvendësimin e produkteve të ndërtimit, si dhe prishjen, transportin dhe menaxhimin e mbetjeve dhe ripërdorimin e tyre, riciklimin dhe asgjësimin përfundimtar;
 34. **“Emetimet e gazeve serrë gjatë përdorimit”** janë emetimet e gazeve serrë që lidhen me konsumin energjetik të sistemeve teknike të ndërtesës gjatë përdorimit dhe funksionimit të ndërtesës të shprehura në $\text{kgCO}_2\text{eq}/(\text{m}^2.\text{y})$;
 35. **“Energji nga burime të rinovueshme”** është energjia e gjeneruar nga burime të rinovueshme jo-fosile, përkatësisht era, dielli (solare termike dhe fotovoltaike diellore) dhe energjia gjeotermale, energjia osmotike, energjia e ambientit, baticat, valët dhe energjitë e tjera të oqeanit, hidrocentralet, biomasa , gazi i landfillit, gazi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza dhe biogazi;
 36. **“Energjia primare”** është energjia prej burimeve të rinovueshme dhe jo të rinovueshme, e cila nuk ka pësuar ndonjë proces transformimi ose shndërrimi;
 37. **“Interval llogaritjeje”** është intervali kohor diskret që përdoret për llogaritjen e performancës energjitike;
 38. **“Kogjenerim”** është gjenerimi i njëkohshëm i energjisë termike dhe elektrike dhe/ose energjisë mekanike nga një proces i vetëm.
 39. **“Librezë rinovimi”** është një udhërrëfyes i përshtatur për rinovimin e thelluar të një ndërtese specifike që përshkruan një numër maksimal masash/ ndërhyrjesh që do të përmirësojnë ndjeshëm performancën e saj energjitike;
 40. **“Mbështjellsja e ndërtesës”** janë elementet konstruktive dhe jokonstruktive të integruar të një ndërtese, të cilat veçojnë ambientin e brendshëm të saj nga ambienti i jashtëm;
 41. **“Ndërtesë banimi ose njësi e ndërtesës”** është një dhomë ose një grup dhomash në një ndërtesë të përhershme ose një pjesë e ndarë strukturore e një ndërtese e cila është projektuar për banim gjatë gjithë vitit nga një familje private;
 42. **“Ndërtesë pa emetime”** është një ndërtesë me performancë shumë të lartë energjitike, siç

përcaktohet në përputhje me Shtojcën I, që kërkon zero ose një sasi shumë të ulët energjie, që nuk gjeneron emetime të dioksidit të karbonit në vendodhje nga karburantet fosile dhe gjeneron zero ose një sasi shumë të ulët të emetimeve operacionale të gazeve serrë, në përputhje me nenin 11;

43. **“Ndërtesë”** është një konstruksion i mbështjellur me çati/soletë/tarracë, dysheme dhe me mure, në të cilin energjia përdoret për të kondicionuar hapësirën e brendshme;
44. **“Ngrohje qendrore”** ose **‘Ftohje qendrore’** do të thotë shpërndarja e energjisë termike në formën e avullit, ujit të nxehtë ose lëngjeve të ftohta, nga një burim qendror ose i decentralizuar prodhimi nëpërmjet një rrjeti tubacionesh, në ndërtesa ose vende të shumta për realizimin e ngrohjes ose ftohjes së ambienteve të brendshme ose realizimin e proceseve;
45. **“Niveli i koston optimale”** është niveli i performancës energjitike, i cili çon në koston më të ulët të mundshme përgjatë gjithë jetëgjatësisë ekonomike të supozuar, ku:
 - a) kostoja më e ulët përcaktohet duke marrë parasysh:
 - i. kategorinë dhe përdorimin e ndërtesës në fjalë;
 - ii. kostot e investimeve të lidhura me energjinë në bazë të parashikimeve zyrtare;
 - iii. kostot e mirëmbajtjes dhe operimit, përfshirë kostot energjitike dhe duke përfshirë gjithashtu dhe kostot për gazet me efekt serrë të lejuara
 - iv. pasojat mjedisore dhe shëndetësore të përdorimit të energjisë;
 - v. fitimet nga energjia e prodhuar në vendodhje, aty ku është e aplikueshme;
 - vi. kostot e menaxhimit të mbetjeve, aty ku është e aplikueshme;
 - b) cikli ekonomik i supozuar i jetëgjatësisë përcaktohet në metodologjinë krahasuese për përcaktimin e nivelit të koston dhe i referohet ciklit ekonomik të supozuar të jetëgjatësisë për të gjithë ndërtesën kur kërkesat e performancës energjitike përcaktohen për ndërtesën në tërësi ose elementëve të ndërtesës kur kërkesat e performancës energjitike përcaktohen për element të ndërtesës.

Niveli i koston optimale duhet të jetë brenda intervalit të niveleve të performancës ku analiza kosto-përfitim e llogaritur gjatë ciklit të vlerësuar të jetës ekonomike është pozitive;

46. **“Njësi e ndërtesës”** është një seksion, një kat, një ndarje/apartament brenda një ndërtese, që është destinuar ose ndryshuar për t’u përdorur veçmas;
47. **“Organet Publike”** janë autoritetet dhe subjektet kombëtare, rajonale ose lokale të financuara dhe administruara drejtpërdrejt nga ato autoritete, por që nuk kanë karakter industrial ose tregtar;
48. **“Parkim i mbuluar/ Parkim me strehë”** është një ndërtim i mbuluar me çati, me të paktën tre vende parkimi makinash, që nuk përdor energji për të kondicionuar ambientin e brendshëm;
49. **“Performanca energjitike e një ndërtese”** është sasia e llogaritur ose e matur e energjisë që nevojitet për të plotësuar kërkesën për energji që lidhet me një përdorim tipik të ndërtesës, e cila përfshin energjinë e përdorur për ngrohje, ftohje, ventilim, ujë të ngrohtë sanitar dhe ndriçim;
50. **“Potenciali i ngrohjes globale gjatë ciklit jetësor”** ose **“PNG gjatë ciklit jetësor”** është një tregues që përcakton kontributin sasior të potencialit të ngrohjes globale të një ndërtese përgjatë ciklit të saj të plotë jetësor i shprehur në $\text{kgCO}_2\text{eq/m}^2$, (sipërfaqe të dobishme);
51. **“Rinovim i konsiderueshëm”** është rinovimi i një ndërtese, ku më shumë se 25 për qind e sipërfaqes së mbështjellses së ndërtesës i nënshtrohet rinovimit;
52. **“Rinovim i thelluar me faza”** është një rinovim i kryer në një numër maksimal hapash, sikurse përcaktohet në librezën e rinovimit;
53. **“Rinovim i thelluar”** është një rinovim që është në përputhje me parimin “efiçenca në krye”, i cili fokusohet në elementët thelbësorë të ndërtesës dhe që transformon një ndërtesë

ose njësi ndërtimi në një ndërtesë ose njësi ndërtimi pa emetime.

54. **“Sistem i mikroizoluar”** është çdo sistem me konsum më të vogël se 500 GWh në vitin 2022, ku nuk ka lidhje me sisteme të tjera;
55. **“Sistemet teknike të ndërtesës”** janë pajisjet teknike të një ndërtese ose të një njësie ndërtese që shërbejnë për ngrohjen/ ftohjen e ambientit të brendshëm, ventilimin, gjenerimin e ujit të ngrohtë sanitar, ndriçimin e integruar, automatizimin dhe kontrollin e ndërtesës, prodhimin e energjisë së rinovueshme në vendodhje dhe depozitimin e energjisë, ose një kombinim i tyre, duke përfshirë ato sisteme që përdorin energji nga burime të rinovueshme;
56. **“Sistemi i ventilimit”** është kombinimi i komponentëve/elementeve që kërkohen për të siguruar këmbimin e ajrit të brendshëm me ajrin e jashtëm, në mënyrë natyrore ose përmes pajisjeve mekanike;
57. **“Sistemi për automatizimin dhe kontrollin e ndërtesës”** është një sistem që përfshin të gjitha produktet, programet kompjuterike dhe shërbimet inxhinierike që mund të mbështesin funksionimin eficient, ekonomik dhe të sigurt të sistemeve teknike të ndërtesave nëpërmjet kontrolleve automatike dhe duke lehtësuar ndërveprimin manual mbi sistemet teknike të ndërtesave;
58. **“Standard evropian”** është një standard të miratuar nga Komiteti Evropian për Standardizim, Komiteti Evropian për Standardizimin Elektroteknik ose Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit dhe i vënë në dispozicion për përdorim publik;
59. **“Stimuj të ndarë”** nënkupton mungesën e shpërndarjes së drejtë dhe të arsyeshme të detyrimeve financiare dhe shpërblimeve në lidhje me investimet në eficientë të energjisë midis aktorëve të interesuar, për shembull pronarët dhe qiramarrësit ose pronarët e ndryshëm të njëjësive të ndërtesave, ose pronarët dhe qiramarrësit ose pronarët e ndryshëm të shumë -ndërtesa apartamentesh ose me shumë qelime.
60. **“Treguesi i energjisë primare të pa rinovueshme”** është një tregues që llogaritet duke ndarë energjinë primare nga burimet e pa rinovueshme për një bartës të caktuar energjie, duke përfshirë energjinë e transferuar dhe humbjet e përgjithshme të llogaritura të energjisë në pikat e përdorimit, nga energjia e transferuar;
61. **“Treguesi i energjisë primare të rinovueshme”** është një tregues që llogaritet duke ndarë energjinë primare nga burimet e rinovueshme nga një burim energjie në vendodhje, afër ose në distancë që transferohet nëpërmjet një bartësi të caktuar energjie, duke përfshirë energjinë e transferuar dhe energjinë e humbur për transmetimin e energjisë në pikat e përdorimit, nga energjia e transferuar;
62. **“Treguesi total i energjisë primare”** nënkupton shumën e treguesve të energjisë primare të rinovueshme dhe jo të rinovueshme për një bartës të caktuar energjie;
63. **“Varfëri energjitike”** nënkupton mungesën e aksesit të një familjeje në shërbimet thelbësore të energjisë, ku shërbime të tilla ofrojnë nivele bazë dhe standarde të mira jetese dhe shëndeti, duke përfshirë ngrohjen adekuate, ujin e ngrohtë, ftohjen, ndriçimin dhe energjinë për përdorimin e pajisjeve elektroshtëpiake, në kontekstin përkatës kombëtar, politika sociale ekzistuese kombëtare dhe politika të tjera përkatëse kombëtare, të shkaktuara nga një kombinim faktorësh, duke përfshirë të paktën mospërbalueshmërinë, të ardhurat e pamjaftueshme të disponueshme, shpenzimet e larta të energjisë dhe performancën e dobët energjitike të shtëpive;
64. **Fuqia nominale efektive** është prodhimi maksimal kalorifik, i shprehur në kE, i specifikuar dhe i garantuar nga prodhuesi që gjenerohet gjatë operimit të vazhdueshëm, ndërkohë që është në përputhje me eficientë të dobishme të treguar nga prodhuesi;
65. **Sistem për kondicionimin e ajrit** është një kombinim i komponentëve të nevojshëm për të siguruar një formë të trajtimit të ajrit të brendshëm, me anë të të cilit temperatura kontrollohet ose mund të ulet.

KREU II

RINOVIMI I STOKUT TË NDËRTESAVE

Neni 5

Plani kombëtar për rinovimin e ndërtesave

1. Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrisë përgjegjëse për energjinë, miraton planin kombëtar për rinovimin e ndërtesave, që përfshin stokun kombëtar të ndërtesave rezidenciale dhe jorezidenciale, publike dhe jopublike me qëllim transformimin në një stok me performancë të lartë energjitike dhe të dekarbonizuar deri në vitin 2050, për transformimin e ndërtesave ekzistuese në ndërtesa pa emetime.
2. Plani kombëtar për rinovimin e ndërtesave përfshin:
 - a) një përmbledhje të stokut kombëtar të ndërtesave për tipologji të ndryshme ndërtesash, duke identifikuar për çdo rast dhe pjesën që zënë në stokun kombëtar të ndërtesave, periudhat e ndërtimit dhe zonat klimatike, bazuar, sipas rastit, në mostrat statistikore dhe bazën e të dhënave kombëtare për certifikatat e performancës energjitike në përputhje me nenin 15, një pasqyrë të barrierave dhe mosfunksionimit të tregut dhe një pasqyrë të kapaciteteve të sektorit të ndërtimit, efikasitetit energjitike dhe burimeve të rionuvshme të energjisë, si dhe pjesën e ndërtesave të përdorura nga familje (me asistencë sociale) në nevojë) bazuar, sipas rastit, në të dhëna statistikore;
 - b) një udhërrëfyes me objektiva të vendosura në nivel kombëtar dhe tregues të matshëm progresi, duke përfshirë reduktimin e numrit të njerëzve të prekur nga varfëria energjitike, me synimin për të arritur objektivin e neutralitetit klimatik në vitin 2050, përmes një stoku kombëtar ndërtesash me efikasitet të lartë energjitike, të dekarbonizuar dhe transformimin e ndërtesave ekzistuese në ndërtesa pa emetime, deri në vitin 2050;
 - c) një pasqyrë të politikave dhe masave të zbatuara dhe të planifikuara, që mbështesin zbatimin e udhërrëfyesit sipas pikës (b);
 - ç) një përmbledhje të nevojave buxhetore për zbatimin e planit kombëtar të rinovimit të ndërtesave, burimet dhe masat e financimit, si dhe burimet administrative për rinovimin e ndërtesave;
 - d) vlerat e lejuara të emetimeve të gazeve serrë gjatë përdorimit dhe kërkesën vjetore për energji primare për një ndërtesë pa emetime, të re ose të rinovuar në përputhje me nenin 11;
 - dh) standardet minimale të performancës energjitike për ndërtesat jorezidenciale mbi bazën e pragjeve maksimale të performancës energjitike në përputhje me nenin 6;
 - e) trajektoren kombëtare për rinovimin e stokut të ndërtesave të banimit, duke përfshirë piketa 2030 dhe 2035 për përdorimin mesatar të energjisë primare në kWh/(m².v) në përputhje me nenin 7; dhe
 - ë) një vlerësim (të bazuar në dëshmi) të kursimeve të pritshme të energjisë dhe përfitimeve më të gjera, duke përfshirë ato që lidhen me cilësinë e mjedisit të brendshëm.
3. Plani kombëtar për rinovimin e ndërtesave është në përputhje me objektivat e përcaktuara dhe në të njëjtën linjë me Planin Kombëtar të Integruar të Energjisë dhe Klimës.
4. Udhërrëfyesi i përmendur në pikën (b) të këtij paragrafi përfshinë:
 - i. objektivat kombëtare për vitet 2030, 2040 dhe 2050 në lidhje me normën vjetore të rinovimit, konsumin e energjisë primare dhe finale të stokut kombëtar të ndërtesave si dhe reduktimet e emetimeve të gazeve serrë gjatë përdorimit;
 - ii. afate specifike kohore për ndërtesat jorezidenciale që të jenë në përputhje me kufijtë

- më të ulët të performancës maksimale të energjisë sipas nenit 6, deri në vitin 2040 dhe 2050, në përputhje me rrugën për transformimin e stokut kombëtar të ndërtesave në ndërtesa pa emetime;
- iii. një vlerësim të bazuar në dëshmi të kursimeve të pritshme të energjisë dhe përfitimeve më të gjera, duke përfshirë ato që lidhen me cilësinë e mjedisit të brendshëm.
5. Plani kombëtar për rinovimin e ndërtesave hartohet duke përdorur formatin e përcaktuar në shtojcën I të këtij ligji dhe rishikohet të paktën çdo pesë vjet. Përpara miratimit dhe pas realizimit të konsultimit publik një kopje e planit dërgohet për mendim tek Sekretariati i Komuniteti të Energjië.
 6. Çdo rekomandim i dhënë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE) pas vlerësimit të planit kombëtar të rinovimit të ndërtesave do të adresohet, ndërsa ato rekomandime që nuk mund të reflektohen, duhet të justifikohen tek SKE dhe të bëhen publike për palët e interesuara.
 7. Çdo herë që plani rishikohet, si pjesë e anekseve të tij duhet të paraqiten detajet e zbatimit dhe implementimit të planit të mëparshëm duke treguar nëse objektivat kombëtar për atë diapazon kohor janë arritur.

Neni 6

Standardet minimale të performancës energjitike për ndërtesat jorezidenciale

1. Plani kombëtar për rinovimin e ndërtesave sipas nenit 5 do të përcaktojë standarde minimale të performancës energjitike për ndërtesat jorezidenciale, të cilat sigurojnë që ato ndërtesa të mos kalojnë pragun e specifikuar të performancës energjitike, siç referohet në nënparagrafin e tretë, të shprehur me një tregues numerik të përdorimit të energjisë primare ose përfundimtare në kWh/(m².v), deri në datat e përcaktuara në nënparagrafin e pestë.
2. Pragjet maksimale të performancës energjitike përcaktohen në bazë të stokut të ndërtesave jorezidenciale, bazuar në informacionin e disponueshëm dhe, sipas rastit, në mostrat statistikore.
3. Në përputhje me pikën 1, Plani kombëtar për rinovimin e ndërtesave do të përcaktojë një prag maksimal të performancës energjitike me qëllim që 16% e stokut kombëtar të ndërtesave jorezidenciale të jetë mbi atë prag (“pragu 16%”) dhe një prag maksimal të performancës energjitike me qëllim që 26% e stokut të tij kombëtar të ndërtesave jorezidenciale të jetë mbi atë prag (“pragu 26%”).
4. Pragjet maksimale të performancës energjitike mund të përcaktohen duke iu referuar stokut kombëtar të ndërtesave jorezidenciale në tërësi ose për llojin/ kategorinë e ndërtesës. Pragu i performancës energjitike mund të korrespondojë me një klas specifik të performancës energjitike.
5. Standardet minimale të performancës energjitike sigurojnë, të paktën, që të gjitha ndërtesat jorezidenciale të jenë më poshtë se:
 - a) pragu prej 16% nga viti 2030; dhe
 - b) pragu prej 26% nga viti 2033.Përputhshmëria e ndërtesave individuale jorezidenciale me pragjet do të kontrollohet në bazë të certifikatave të performancës energjitike ose, sipas rastit, mjeteve të tjera të disponueshme.
6. Në udhërrëfyesin e referuar në nenin 5(2), pika (b), përcaktohen afate specifike kohore për ndërtesat jorezidenciale që të jenë në përputhje me pragjet më të ulët të performancës maksimale energjitike deri në vitin 2040 dhe 2050, në përputhje me rrugën për transformimin e stoku kombëtar të ndërtesave në ndërtesa pa emetime.
7. Ministria përgjegjëse për energjinë në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban përcaktojnë dhe publikojnë kritere për të përjashtuar ndërtesat

- individuale jo-rezidenciale, duke pasur parasysh:
- a) përdorimin e pritshëm të këtyre ndërtesave në të ardhmen;
 - b) vështirësitë e konsiderueshme për një ndërtesë ose tipologji ndërtesash;
 - c) ose në rastin e një vlerësimi të pafavorshëm kosto-përfitim, nga kërkesat në këtë paragraf.
8. Çdo kriter sipas pikës 7, duhet të jetë i qartë, i saktë, strikt dhe do të sigurojë trajtim të barabartë ndërmjet ndërtesave jorezidenciale.
 9. Për përcaktimin e këtyre kritereve, institucioni përgjegjës do të realizojë vlerësimin *ex ante* të pjesës së mundshme të ndërtesave jorezidenciale të mbuluara dhe do të shmangin përjashtimin e një numri joproporcional të ndërtesave jorezidenciale.
 10. Kriteret e përcaktuara do të jenë pjesë e raportimeve të realizuara në kuadër të Planit Kombëtar për rinovimin e ndërtesave të paraqitur tek SKE në përputhje me nenin 5.
 11. Pavarësisht vendosjes së kritereve për përjashtimin e ndërtesave në përputhje me paragrafin e mësipërm, duhet të garantohet arritja për përmirësime ekuivalente të performancës energjitime në pjesë të tjera të stokut të ndërtesave jorezidenciale.
 12. Kur rinovimi i nevojshëm për arritjen e pragjeve të performancës energjitime të specifikuar në këtë nen ka një vlerësim të pafavorshëm kosto-përfitim për një ndërtesë të caktuar jorezidenciale, për atë ndërtesë të caktuar jorezidenciale, zbatohen të paktën ato masa individuale rinovimi të cilat rezultojnë me një vlerësim të favorshëm kosto-përfitim.
 13. Në rastin kur stoku kombëtar i ndërtesave jorezidenciale, ose një pjesë e tij, dëmtohet në mënyrë të konsiderueshme nga një fatkeqësi natyrore, ministria përgjegjëse për energjinë në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban mund të rregullojë përkohësisht prapë maksimal të performancës energjitime në mënyrë që rinovimi energjetik i ndërtesave jorezidenciale të dëmtuara të zëvendësojë rinovimin energjetik të ndërtesave të tjera jorezidenciale me performancën më të keqe, ndërkohë që sigurohet që një përqindje e ngjashme e stokut të ndërtesave jorezidenciale t'i nënshtrohet rinovimit energjetik. Pragu maksimal i performancës energjitime i përcaktuar dhe kohëzgjatja e tij raportohen në Planin kombëtar për rinovimin e ndërtesave.
 14. Në përputhje me nenin 30, mbështetja për zbatimin e standardeve minimale të performancës energjitime do të garantohet me të gjitha masat e mëposhtme:
 - a) sigurimin e masave të duhura financiare, veçanërisht ato që synojnë familjet e cenueshme, njerëzit e prekur nga varfëria energjitime ose, kur është e aplikueshme, që jetojnë në banesa sociale;
 - b) dhënien e asistencës teknike, duke përfshirë edhe shërbime me një ndalesë me fokus të veçantë në familjet e cenueshme dhe, aty ku është e aplikueshme, njerëzit që jetojnë në banesa sociale;
 - c) hartimin e skemave të integruara të financimit të cilat ofrojnë stimuj për rinovime të thelluara dhe rinovime të thelluara me faza;
 - ç) heqja e barrierave joekonomike, duke përfshirë stimujt e ndarë; dhe
 - d) monitorimin e ndikimeve sociale, veçanërisht në familjet më të cenueshme.
 15. Çdo ndërtesë që rinovohet në mënyrë që të përputhet me një standard minimal të performancës energjitime, duhet të sigurojë përputhjen me kërkesat minimale të performancës energjitime për elementët e ndërtesës në përputhje me nenin 9 dhe, në rastin e rinovimit të konsiderueshëm, me kërkesat minimale për performancën energjitime për ndërtesat ekzistuese sipas nenit 13.

Neni 7

Trajktoret për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave të banimit

1. Plani Kombëtar për rinovimin e ndërtesave do të përcaktojë një trajktore kombëtare për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave të banimit në përputhje me udhërrëfyesin

- kombëtar dhe objektivat 2030, 2040 dhe 2050, me synim transformimin e stokut kombëtar të ndërtesave në një stok ndërtesash pa emetime deri në vitin 2050. Trajektorja kombëtare për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave të banimit do të përcaktohet si një zvogëlim i përdorimit mesatar të energjisë primare në kWh/(m².v) për të gjithë stokun e ndërtesave të banimit gjatë periudhës 2020 – 2050 dhe do të identifikojë numrin e ndërtesave të banimit dhe njësitë të ndërtesave të banimit ose sipërfaqes së dyshemesë që do të rinovohet çdo vit, duke përfshirë numrin ose sipërfaqen e dyshemesë së 43% të ndërtesave të banimit dhe njësitë të ndërtesave të banimit me performancën energjitime më të ulët.
2. Trajektoret për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave të banimit sigurojnë që përdorimi mesatar i energjisë primare në kWh/(m².v) i të gjithë stokut të ndërtesave të banimit:
 - a) zvogëlohet me të paktën 16 % krahasuar me 2020 deri në vitin 2030;
 - b) ulet me të paktën 20-22 % krahasuar me 2020 deri në vitin 2035;
 - c) deri në vitin 2040, dhe çdo 5 vjet më pas, është ekuivalente ose më e ulët se vlera e përcaktuar në nivel kombëtar që rrjedh nga një rënie progresive e përdorimit mesatar të energjisë primare nga viti 2030 në 2050, në përputhje me transformimin e stokut të ndërtesave të banimit në një stok ndërtesash pa emetime.
 3. Trajektoret garantojnë që të paktën 55% e uljes së përdorimit mesatar të energjisë primare të përmendur në nënparagrafin në vijim të arrihet nëpërmjet rinovimit të ndërtesës rezidenciale me performancën më të keqe prej 43%.
 4. Për të arritur uljen e kërkuar të përdorimit mesatar të energjisë primare të të gjithë stokut të ndërtesave të banimit, do të përdoren masa të tilla si standardet minimale të performancës energjitime sipas nenit 6, asistenca teknike përmes sporteve me një ndalesë sipas nenit 33 dhe masa mbështetëse financiare në përputhje me nenin 31.
 5. Plani Kombëtar për rinovimin e ndërtesave nuk përjashton në mënyrë disproporcionale ndërtesat e banimit ose njësitë e ndërtesave me qira.
 6. Metodologjia e përdorur dhe të dhënat e mbledhura për vlerësimin e vlerave të përmendura në nënparagrafin e dytë dhe të tretë raportohen në planin kombëtar të rinovimit të ndërtesave.
 7. Trajektorja kombëtare për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave të banimit do t'i referohet të dhënave për stokun kombëtar të ndërtesave të banimit, bazuar, sipas rastit, në mostrat statistikore dhe certifikatat e performancës energjitime.
 8. Përveç përdorimit të energjisë primare të përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, trajektorët për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave të banimit mund të përcaktojnë tregues shtesë të përdorimit të energjisë primare jo të rinovueshme dhe të rinovueshme, dhe të emetimeve operacionale të gazeve serrë të prodhuara në kg CO₂ek/(m².y). Për të siguruar reduktimin e emetimeve operacionale të gazeve serrë, standardet minimale të performancës energjitime duhet të marrin parasysh nenin 15a(1) të Direktivës (BE) 2018/2001.

KREU III

METODOLOGJITË E LLOGARITJES DHE KËRKESAT E PERFORMANCËS ENERJITIKE

Neni 8

Metodologjia kombëtare për llogaritjen e performancës energjitime të ndërtesave

1. Performanca energjitime e një ndërtese përcaktohet në bazë të konsumit të llogaritur ose të matur të energjisë dhe pasqyron një përdorimin tipik të energjisë për ngrohjen e ambienteve, ftohjen e ambienteve, ujin e ngrohtë sanitar, ventilimin, ndriçimin e integruar

- dhe sistemet e tjera teknike të ndërtesave.
2. Përdorimi tipik i energjisë është përfaqësues i kushteve aktuale të funksionimit për çdo tipologji përkatëse dhe pasqyron sjelljen tipike të përdoruesit. Kur është e mundur, përdorimi tipik i energjisë dhe sjellja tipike e përdoruesve bazohen në statistikat kombëtare të disponueshme, kodet e ndërtimit dhe në të dhënat të matura.
 3. Kur konsumi i matur i energjisë është baza për llogaritjen e performancës energjitike të ndërtesave, metodologjia e llogaritjes duhet të jetë në gjendje të identifikojë ndikimin e sjelljes së banorëve dhe klimës lokale, e cila nuk duhet të pasqyrohet në rezultatin e llogaritjes. Konsumi i matur i energjisë për qëllimin e llogaritjes së performancës energjitike të ndërtesave duhet të kërkojë lexime të paktën në intervale mujore dhe duhet të bëjë dallimin midis bartësve të energjisë.
 4. Metodologjia kombëtare e llogaritjes mund të përfshijë konsumin e matur të energjisë në kushte tipike përdorimi për të verifikuar saktësinë e konsumit të llogaritur të energjisë dhe për të mundësuar krahasimin midis performancës së llogaritur dhe asaj aktuale. Konsumi i matur i energjisë për qëllime verifikimi dhe krahasimi mund të bazohet në leximet mujore.
 5. Performanca energjitike e një ndërtese shprehet me një tregues numerik të përdorimit të energjisë primare për njësi të sipërfaqes referuese të dyshemesë në vit, në kWh/(m².v) për qëllime të certifikimit të performancës energjitike dhe përputhshmërisë me kërkesat minimale të performancës energjitike. Metodologjia e aplikuar për përcaktimin e performancës energjitike të një ndërtese duhet të jetë transparente dhe e hapur ndaj risive.
 6. Metodologjia kombëtare e llogaritjes ndërtohet mbi bazën e standardeve kryesore evropiane për performancën energjitike të ndërtesave, përkatësisht (EN) ISO 52000-1, (EN) ISO 52003-1, (EN) ISO 52010-1, (EN) ISO 52016-1, (EN) ISO 52018-1, (EN) ISO 52120-1, EN 16798-1 dhe EN 17423 ose dokumente që zëvendësojnë. Kjo dispozitë nuk përbën një kodifikim ligjor të këtyre standardeve.
 7. Kur ndërtesat furnizohen nga sistemet e ngrohjes ose ftohjes qendrore, përfitimet e një furnizimi të tillë njihen dhe llogariten në metodologjinë e llogaritjes, në veçanti pjesa e energjisë së rinovueshme, nëpërmjet faktorëve të energjisë primare të njohur ose certifikuar.
 8. Kërkesa për energji dhe konsumi i energjisë për ngrohjen e hapësirave, ftohjen e hapësirës, ujin e ngrohtë, ventilimin, ndriçimin dhe sistemet e tjera teknike të ndërtesave llogariten duke përdorur intervalet e llogaritjes kohore mujore, orare ose nën-orëshe për të llogaritur kushtet e ndryshme që në mënyrë të konsiderueshme ndikojnë në funksionimin dhe performancën e sistemit dhe në kushtet e brendshme, dhe të optimizojë shëndetin, cilësinë e ajrit të brendshëm, duke përfshirë nivelet e rehatisë, të përcaktuara në nivel kombëtar ose rajonal.
 9. Kur rregulloret specifike të produktit për produktet me ndikim në energji të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për projektimin ekologjik përfshijnë kërkesa specifike për informacionin e produktit për qëllimin e llogaritjes së performancës energjitike dhe PNG gjatë ciklit jetësor sipas kësaj ligji, metodat kombëtare të llogaritjes nuk kërkojnë informacion shtesë.
 10. Llogaritja e energjisë primare do të bazohet në faktorët e energjisë primare të përditësuar rregullisht dhe afatgjatë (duke diferencuar energjinë jo të rinovueshme, të rinovueshme dhe totale) ose në faktorë të ponderuar për bartës energjetik, të cilat njihen nga autoritetet kombëtare dhe duke marrë parasysh përzierjen e pritshme të energjisë në bazë të planit kombëtar të energjisë dhe klimës. Faktorë e energjisë primare ose faktorët e ponderuar mund të bazohen në informacione kombëtare, rajonale ose lokale. Faktorët e energjisë primar ose faktorët e ponderuar mund të vendosen në baza vjetore, sezonale, mujore, ditore ose orare ose mbi informacione më specifike të disponueshme për sistemet e distrikteve individuale.

11. Faktorët e energjisë primare ose faktorët e ponderuar përcaktohen në metodologjinë kombëtare të llogaritjes dhe zgjedhjet e bëra dhe burimet e të dhënave raportohen sipas standardeve europiane EN 17423 ose çdo dokumenti zëvendësues.
12. Me qëllim përcaktimin e performancës energjitike të një ndërtese, metodologjia kombëtare për llogaritjen e performancës energjitike të ndërtesave do të përfshijë tregues numerikë shtesë të përdorimit të energjisë primare totale, jo të rinovueshme dhe të rinovueshme, dhe të emetimeve të gazeve serrë të gjeneruara gjatë përdorimit, në $\text{kg CO}_2\text{ek}/(\text{m}^2 \cdot \text{v})$.
13. Metodologjia për llogaritjen e performancës energjitike të ndërtesave përfshinë të paktën elementet e mëposhtme:
 - a) karakteristikat aktuale termike të ndërtesës duke përfshirë ndarjet e brendshme të saj:
 - i. kapacitetin termik
 - ii. izolimin termik
 - iii. ngrohjen pasive
 - iv. elementët ftohës
 - v. nyjet termike
 - b) sistemet për ngrohjen dhe furnizimi me ujë të ngrohtë sanitar, duke përfshirë karakteristikat e tyre respektivisht izolimit termik;
 - c) kapaciteti i instaluar në vendodhje për prodhimin e energjisë së rinovueshme dhe depozitimit të energjisë;
 - ç) sistemet për kondicionimin e ajrit
 - d) sistemet e ventilimit mekanik dhe instalimet për ventilim natyror të cilët mund të përfshijë shmangien e infiltrimeve të ajrit dhe rikuperimin e nxehtësisë;
 - dh) ndriçimi i integruar (kryesisht në sektorin jorezidencial);
 - e) projektimi, pozicionimi dhe orientimi i ndërtesës, duke përfshirë kushtet e jashtme klimatike;
 - ë) sisteme diellore pasive dhe sistemet për shmangien e rrezatimit diellor;
 - f) kushtet klimatike të brendshme, duke përfshirë klimën e brendshme të projektuar;
 - g) ngarkesat termike të brendshme;
 - gj) sistemet e automatizimit dhe kontrollit të ndërtesave dhe kapacitetet e tyre për të monitoruar, kontrolluar dhe optimizuar performancën energjitike.
14. Përveç sa më lart, merret parasysh dhe ndikimi pozitiv i aspekteve të mëposhtme:
 - a) kushtet lokale të ekspozimit diellor, sistemet diellore aktive dhe sistemet e tjera të ngrohjes dhe energjisë elektrike në bazë të shfrytëzimit të energjisë nga burimet e rinovueshme;
 - b) energjia elektrike e prodhuar nga kogjenerimi;
 - c) sistemet e ngrohjes dhe ftohjes qëndrore (qytetase ose bollqe banimi);
 - ç) ndriçim natyral;
 - d) sistemet e depozitimit të energjisë elektrike;
 - dh) sistemet e depozitimit të energjisë termike.
15. Për qëllime të llogaritjes së performancës energjitike, ndërtesat klasifikohen sipas kategorive në vijim:
 - a) tipat e ndryshëm të shtëpive/ndërtesave ku banon vetëm një familje;
 - b) blloqet e apartamenteve;
 - c) zyrat;
 - ç) ndërtesat e edukimit/arsimimit;
 - d) spitalet;
 - dh) hotelet dhe restorantet;
 - e) objektet sportive;

- ë) ndërtesat ku zhvillohen aktivitete të tregtisë me shumicë ose pakicë që klasifikohen si ndërtesa shërbimi;
 - f) tipa të tjerë ndërtesash që konsumojnë energji
16. Metodologjia kombëtare për llogaritjen e performancës energjitike të ndërtesave miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për energjinë.

Neni 9

Kërkesat minimale të performancës energjitike të ndërtesave

1. Kërkesat minimale të performancës energjitike për ndërtesat ose njësitë e ndërtesave përcaktohen me vendim të këshillit të ministrave dhe kanë si synim, të paktën arritjen e nivelit të kostos optimale dhe aty ku është e përshtatshme, kërkesa më të larta veçanërisht për ndërtesat pa emetime. Performanca energjitike llogaritet në përputhje me metodologjinë e specifikuar në nenin 8. Nivelet e kostos optimale llogariten në përputhje me kornizën metodologjike krahasuese të përmendur në nenin 10.
2. Kërkesat minimale të performancës energjitike vendosen për elementët e ndërtesës që përbëjnë pjesë të mbështjelljes së ndërtesës dhe që kanë një ndikim të konsiderueshëm në performancën energjitike të mbështjelljes së ndërtesës kur ato zëvendësohen ose riparohen, me qëllim për të arritur të paktën nivelin e kostos optimale. Kërkesat minimale për performancën energjitike hartohen që të përfshijnë elementët e ndërtimit në atë nivel që do të lehtësonte instalimin efektiv të sistemeve të ngrohjes me temperaturë të ulët në ndërtesat e rinovuara.
3. Kërkesat minimale të performancës energjitike marrin parasysh cilësinë optimale të mjedisit të brendshëm, në mënyrë që të shmangen efektet e mundshme negative si ventilim i pamjaftueshëm, kushtet lokale të komfortit, funksioni dhe aktivitetin e ndërtesës si dhe vjetërsinë e ndërtesës.
4. Kërkesat minimale të performancës energjitike rishikohen të paktën çdo pesë vjet dhe nëse është e nevojshme, përditësohen në mënyrë që të pasqyrojnë progresin teknik në sektorin e ndërtimit, rezultatet e llogaritjes së kostos optimale të përcaktuara në neni 10, objektivat dhe politikat e përditësuara kombëtare të energjisë dhe klimës.
5. Kategoritë e ndërtesave që përjashtohen nga detyrimet për zbatimin e kërkesave minimale për performancën energjitike në ndërtesa miratohen në përputhje me pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 10

Llogaritja e nivelit të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës energjitike të ndërtesave

1. Niveli i kostos optimale për kërkesat minimale të performancës energjitike llogaritet duke përdorur metodologjinë krahasuese për përcaktimin e nivelit të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës energjitike për ndërtesat dhe elementët e ndërtesave.
2. Llogaritja e nivelit optimal të kostos për kërkesat minimale të performancës energjitike realizohet duke përdorur metodologjinë sipas pikës 1 dhe parametra të tjerë sikurse kushtet klimatike dhe aksesueshmëria e infrastrukturës energjitike. Rezultatet e llogaritjes krahasohen me kërkesat minimale të performancës energjitike në fuqi.
3. Rezultatet e llogaritjes së kostos optimale sipas procedurës së mësipërme pasqyrohen në raportin kombëtar të kostos optimale dhe bëhen publike për të gjithë palët e interesuara nga ministra përgjegjëse për energjinë.
4. Të gjitha të dhënat hyrëse dhe supozimet e përdorura për llogaritjet e niveleve të kostos optimale të kërkesave minimale të performancës energjitike dhe rezultatet e këtyre

- Ilogaritjeve raportohen tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Format i për raportim miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.
5. Nëse rezultati i krahasimit të kryer në përputhje me paragrafin 2 tregon se kërkesat minimale të performancës energjitike në fuqi janë më pak efikente në konsumin energjetik sesa nivelet e kostos optimale të kërkesave të performancës minimale të energjisë me më shumë se 15 %, kërkesat minimale të performancës energjitike do të rishikohen brenda 24 muajve nga disponueshmëria e rezultateve të krahasimit.
 6. Metodologjia sipas pikës 1 miratohet me vendim të këshillit të ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe ndër të tjera:
 - a) përcakton ndërtesat referente që karakterizohen dhe përfaqësojnë funksionalitetin dhe vendndodhjen e tyre gjeografike, duke përfshirë kushtet klimatike të brendshme dhe të jashtme. Ndërtesat referuese duhet të mbulojnë ndërtesat e banimit dhe ato jo-rezidenciale, qofshin ato të reja apo ekzistuese;
 - b) përcakton masat e efikasitetit energjetik që do të vlerësohen për ndërtesat referente. Këto mund të jenë masa për ndërtesa individuale në tërësi, për elemente të veçanta ndërtimi ose për një kombinim të elementeve të ndërtimit;
 - c) vlerëson nevojën për energji finale dhe primare si dhe emetimet rezultuese të ndërtesave referente me masat e përcaktuara të efikasitetit energjetik kur ato aplikohen;
 - ç) llogarit kostot (dmth vlerën aktuale neto “NPV”) të masave të efikasitetit të energjisë (siç përmendet në paragrafin e dytë) gjatë ciklit të pritshëm të jetës ekonomike të aplikuar për ndërtesat referente (siç përmendet në paragrafin e parë) duke zbatuar parimet e kuadrit të metodologjisë krahasuese.

KREU IV DETYRIMET DHE CERTIFIKATAT E PERFORMANCËS ENERJITIKE PËR NDËRTE SAT

Neni 11 Ndërtesat pa emetime

1. Ndërtesat pa emetime janë ato ndërtesa të cilat gjatë përdorimit nuk çlirojnë asnjë gaz me efekt serrë në vendodhje nga lëndët djegëse fosile dhe kur është e mundur nga pikëpamja ekonomike dhe teknike, zotërojnë kapacitetin e nevojshëm për të reaguar ndaj sinjaleve të jashtme për të përshtatur përdorimin, prodhimin dhe depozitimin e energjisë.
2. Ndërtesat pa emetime:
 - a) kanë një kërkesë për energji më të vogël se kërkesa e përcaktuar në kWh/m²/v, sipas vendimit të pikës 18 në nenin 15;
 - b) kërkesa për energji sipas shkronjës a, përkon me arritjen e nivelit të kostos optimale dhe do të ndryshojë sa herë që niveli i kostos optimale rillogaritet përmes raportit kombëtar të kostos optimale;
 - c) në varësi të rezultateve të raportit kombëtar të kostos optimale, kërkesa për energji mund të reduktohet më tej.
3. Pragu maksimal i emetimeve të gazeve me efekt serrë për operimin e ndërtesave pa emetime përcaktohet në planin kombëtar për rinovimin e ndërtesave dhe përfshin tregues për ndërtesat e reja dhe ato që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.
4. Pragjet masimale përfshirë dhe një përshkrim të metodologjisë së llogaritjes në varësi të tipologjisë së ndërtesës dhe kushteve të jashtme klimatike i raportohen Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
5. Energjia totale primare që përdoret nga një ndërtesë pa emetime, e re ose e rinovuar

mbulohet nga:

- a) energji e gjeneruar nga burime të rinovueshme të prodhuara në vendodhje, pranë ndërtesës ose nga një komunitet i energjive të rinovueshme, duke përmbushur kriteret e përcaktuara në ligjin përgjegjës për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme;
 - b) energji e gjeneruar nga një sistem alternativ me efikasitet të lartë për ngrohjen dhe ftohjen;
 - c) energji e gjeneruar nga burime që nuk përmbajnë karbon.
6. Kur nuk është e mundur nga pikëpamja teknike dhe ekonomike për të përmbushur kriteret e vendosura në këtë paragraf, energjia primare totale mund të mbulohet gjithashtu nga energjia elektrike e rrjetit elektroenergetik kombëtar.

Neni 12 **Detyrimet për ndërtesat e reja**

1. Të gjitha ndërtesat e reja që do të ndërtohen, do të jenë ndërtesa pa emetime në përputhje me nenin 11:
 - a) nga 1 janari i vitit 2028, ndërtesat e reja në pronësi të organeve publike, dhe
 - b) nga 1 janari i vitit 2030, të gjitha ndërtesat e reja.Deri në zbatimin e kërkesave sipas paragrafit të mësipërm, të gjitha ndërtesat e reja do të jenë të paktën në përputhje me kërkesat minimale të performancës energjitike të përcaktuara në nenin 9.
2. Nga 1 Janari i vitit 2027 çdo ndërtesë që merret në përdorim ose në pronësi nga autoritetet publike do të jetë një ndërtesë pa emetime.
3. PNG gjatë ciklit jetësor është një tregues numerik i llogaritur në përputhje metodologjinë e hartuar sipas pikës 4 dhe përfshihet në certifikatën e performancës energjitike të ndërtesës:
 - a) nga 1 janari 2028, për të gjitha ndërtesat e reja me sipërfaqe të dobishme më të madhe se 1000 m²;
 - b) nga 1 janari 2030, për të gjitha ndërtesat e reja.
4. Metodologjia kombëtare për llogaritjen e PNG gjatë ciklit jetësor për ndërtesat e reja miratohet me vendim të këshillit të ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë.
5. Deri më 1 Janar 2029 ministria përgjegjëse për energjinë do të publikojë dhe dërgojë tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë një udhërrëfyes që detajon prezantimin e vlerave e lejuara të PNG totale kumulative të ciklit jetësor të të gjitha ndërtesave të reja dhe vendosë objektiva për ndërtesat e reja nga viti 2030, duke marrë parasysh një tendencë në rënie progresive, si dhe vlerat maksimale të lejuara, të detajuara për zona të ndryshme klimatike dhe tipologji të ndryshme ndërtesash. Vlera maksimale të lejuara do të jenë në përputhje me objektivin për arritjen e neutralitetit klimatik.
6. Të gjitha ndërtesat e reja përfshijnë në fazën e projektimit, apikimit për leje ndërtimi dhe aplikimin për leje shfrytëzimi të gjithë dokumentacionin, projektin dhe informacionin e nevojshëm që vërteton adresimin e çështjeve të mëposhtme:
 - a) cilësinë e mjedisit të brendshëm në ndërtesa;
 - b) adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike;
 - c) mbrojtjen nga zjarri;
 - ç) sigurinë sizmike;
 - d) aksesueshmërinë në ndërtesë për personat me aftësi të kufizuara.
7. Këshilli i ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për zhvillimin urban miraton vendimin për plotësimin dhe verifikimin e

detyrimeve që i adresohen ndërtesave të reja, ndërtesave ekzistuese dhe ndërtesave që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm respektivisht këtij ligji.

Neni 13

Detyrimet për ndërtesat ekzistuese

1. Ndërtesat ose njësitë e ndërtesave që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm, plotësojnë të paktën kërkesat minimale të performancës energjitike të përcaktuara në përputhje me nenin 9, në tërësi ose për elementët që i nënshtrohen rinovimit për aq sa janë teknikisht, funksionalisht të realizueshme dhe ekonomikisht në përputhje me nivelet e kostos optimale.
2. Kur një element ndërtimi që është pjesë e mbështjelljes së ndërtesës ose njësisë së ndërtesës dhe ka një ndikim të konsiderueshëm në performancën energjitike të mbështjellësit të ndërtesës, riparohet ose zëvendësohet, elementi i ndërtimit duhet të plotësojë kërkesat minimale të performancës energjitike për aq sa është teknikisht, funksionalisht e realizueshme dhe ekonomikisht në përputhje me nivelet e kostos optimale.
3. Për ndërtesat që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm, subjektet zhvilluese duhet të garantojnë:
 - a) cilësinë e ambienteve të brendshme respektivisht kërkesave minimale të performancës energjitike;
 - b) zëvendësimin e sistemeve teknike që shfrytëzojnë burime fosile kur sistemi teknik do i nënshtrohet rinovimit;
 - c) përshtatshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike;
 - ç) mbrojtjen nga zjarri;
 - d) sigurinë sizmike;
 - dh) largimin e substancave të rrezikshme;
 - e) aksesueshmërinë në ndërtesë për personat me aftësi të kufizuara.
4. Njësitë e qeverisjes vendore, marrin të gjitha masat e nevojshme për të garnatuar plotësimin e kërkesave të këtij neni për çdo ndërtesë që aplikon për tu pajisur me leje ndërtimi/ punimesh për:
 - a) ndërhyrjet me qëllim ruajtjen apo rritjen e eficiencës energjitike dhe akustike në një strukturë ekzistuese
 - b) riparimi dhe zëvendësimi i dritareve e i dyerve, qepenave dhe vitrinave
 - c) zëvendësimi, riparimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë
 - ç) riparimi i ballkoneve, terracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse;
 - d) riparimi dhe rinovimi i dyshemesë në kontakt me tokën, ose në kontakt me hapësira të pakondicionuara;
 - dh) zëvendësimi i sistemeve të ujit të ngrohtë sanitar dhe të sistemeve të ngrohjes/ftohjes së ndërtesave.
 - e) instalimin e sistemeve që shfrytëzojnë energjinë e rinovueshme në ndërtesë ose pranë ndërtesës.

Neni 14

Infrastruktura për lëvizshmëri të qëndrueshme

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ndërtesat e reja jo-rezidenciale me më shumë se pesë vende parkimi makinash dhe ndërtesat jorezidenciale që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm, me më shumë se pesë vende parkimi makinash duhet të projektojnë dhe ndërtojnë infrastrukturën e nevojshme për:
 - a) instalimin e të paktën 1 pike karikimi për çdo 5 vendpushimi makinash;

- b) instalimin e sistemeve dhe tubacioneve të nevojshëm për çdo vendpushim makinash për të mundësuar më vonë lidhjen e pikave të karikimit për çdo vendpushim.
 - c) garantimin e hapësirave për pushimin e biçikletave duke marrë parasysh hapësirën e kërkuar edhe për biçikletat me dimensione më të mëdha se biçikletat standarde, të paktën 1 vendpushim për çdo 50m² sipërfaqe të dobishme të ndërtesës.
2. Instalimi i sistemeve të nevojshme të përmendur në pikën (b) të nënparagrafit të parë të dimensionohen në mënyrë që të mundësojnë përdorimin e njëkohshëm dhe eficient të numrit të kërkuar të pikave të rimbushjes dhe mbështesin, sipas rastit, instalimin e një sistemin e menaxhimit të ngarkesës ose karikimit, në masën që kjo është teknikisht dhe ekonomikisht e realizueshme dhe e justifikueshme.
 3. Me përjashtim të pikës (a) të nënparagrafit të parë, për ndërtesat e reja të zyrave dhe ndërtesat ekzistuese të zyrave që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm, me më shumë se pesë vende parkimi, subjektet zhvilluese sigurojnë instalimin e të paktën një pike rimbushjeje për çdo dy vende parkimi.
 4. Parashikimet sipas pikës 1 zbatohen kur:
 - a) Vendpushimi është i pozicionuar në brendësi të ndërtesës, dhe për rinovime të konsiderueshme, rinovimi do të përfshijë edhe hapësirën e vendpushimit ose infrastrukturën elektrike të ndërtesës;
 - b) Vendpushimi është fizikisht pranë ose ngjitur me ndërtesën dhe për rinovime të konsiderueshme, rinovimi do të përfshijë edhe hapësirën e vendpushimit ose infrastrukturën elektrike të ndërtesës.
 5. Ndërtesat e reja të banimit dhe ndërtesat e banimit që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm, me më shumë se tre vendpushime makinash duhet të projektojnë dhe ndërtojnë infrastrukturën e nevojshme për:
 - a) instalimin e sistemeve të nevojshëm për çdo vendpushim makinash për të mundësuar më vonë lidhjen e pikave të karikimit për çdo vendpushim;
 - b) garantimin e hapësirave për pushimin e biçikletave duke marrë parasysh hapësirën e kërkuar edhe për biçikletat me dimensione më të mëdha se biçikletat standarde, të paktën 2 vendpushime për çdo njësi banimi.
 6. Parashikimet sipas pikës 3 zbatohen kur:
 - a) Vendpushimi është i pozicionuar në brendësi të ndërtesës, dhe për rinovime të konsiderueshme, rinovimi do të përfshijë edhe hapësirën e vendpushimit ose infrastrukturën elektrike të ndërtesës;
 - b) Vendpushimi është fizikisht pranë ose ngjitur me ndërtesën dhe në rastin e rinovimeve të konsiderueshme, rinovimi do të përfshijë edhe hapësirën e vendpushimit ose infrastrukturën elektrike të ndërtesës.
 7. Këshilli i ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për infrastrukturën miraton vendimin për përcaktimin e kërkesave, kritereve dhe kushteve dhe procedurave për instalimin e infrastrukturës së qëndrueshme në ndërtesa.

Neni 15

Certifikata e performancës energjitike

1. Certifikatat e performancës energjitike gjenerohen përmes programeve kompjuterike të miratuara që funksionojnë mbi bazën e metodologjisë për llogaritjen e performancës energjitike të ndërtesave në përputhje me nenin 5.
2. Programet kompjuterike për gjenerimin e certifikatave të performancës energjitike miratohen nga ministria përgjegjëse për energjinë.
3. Ministria përgjegjëse për energjinë garanton për të paktën një program kompjuterik, aksesimin dhe përdorimin pa kosto, për të gjithë palët e interesuara.

4. Certifikatat e performancës energjitike përdorin shkallën nga A+ në G për të diferencuar ndërtesat në varësi të konsumit të tyre energjetik. Klasi A+ korrespondon me një ndërtesë me prapagun maksimal të kërkesës për energji, i cili është të paktën 20% më i ulët se kufiri maksimal për ndërtesat pa emetime dhe që gjeneron më shumë energji të rinovueshme në vendodhje çdo vit nga sa është kërkesa totale vjetore për energji primare.
5. Certifikatat e performancës energjitike përfshijnë rekomandime për përmirësimin e performancës energjitike në përputhje me nivelin e kostos optimale, reduktimin e emetimeve gjatë përdorimit tipik të ndërtesës dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit të brendshëm.
6. Kërkesat sipas pikës 5 nuk aplikohen për ndërtesat që klasifikohen në klasin energjetik A dhe A+.
7. Rekomandimet që përfshihen në certifikatën e performancës energjitike do të përfshijnë:
 - a) masat e efijçencës në lidhje me një rinovim të konsiderueshëm të mbështjellësës së ndërtesës ose të sistemit/eve teknike të ndërtesës.
 - b) masat e efijçencës për elementë të veçantë të mbështjellësës së ndërtesës ose të sistemit/eve teknike të ndërtesës, që nuk klasifikohen si një rinovim i konsiderueshëm.
8. Kur certifikata e performancës energjitike shoqërohet me librezën e rinovimit, rekomandimet sipas pikës 7 përfshihen vetëm në librezën e rinovimit.
9. Rekomandimet e përfshira në certifikatën e performancës energjitike janë teknikisht të realizueshme për ndërtesën specifike dhe ofrojnë një vlerësim për kursimet e energjisë si dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë gjatë përdorimit të ndërtesës. Çdo rekomandim shoqërohet me një vlerësim të periudhës së vetëshlyerjes gjatë gjithë ciklit jetësor të investimit si dhe informacion mbi stimujt financiarë të disponueshëm, ndihmën administrative dhe teknike, si dhe përfitimet financiare që lidhen me arritjen e vlerave referente.
10. Rekomandimet përfshijnë një vlerësim nëse sistemet e ngrohjes, sistemet e ventilimit, sistemet e ajrit të kondicionuar dhe sistemet e ujit të ngrohtë sanitar mund të përshtaten për të funksionuar në një temperaturë që rrit efijçencën.
11. Rekomandimet përfshijnë një vlerësim të jetëgjatësisë së mbetur të sistemit të ngrohjes ose sistemit të kondicionimit të ajrit. Aty ku është e përshtatshme, rekomandimet do të tregojnë alternativat e mundshme për zëvendësimin e sistemit të ngrohjes ose të sistemit të kondicionimit të ajrit, në përputhje me objektivat klimatike 2030 dhe 2050, duke marrë parasysh kushtet lokale dhe mundësitë e lidhura me sistemin.
12. Certifikata e performancës energjitike tregojë se ku pronari ose qiramarrësi i ndërtesës ose njësisë së ndërtesës mund të marrë informacion më të detajuar, duke përfshirë kosto-efektivitetin e rekomandimeve të bëra në certifikatën e performancës energjitike. Vlerësimi i efektivitetit të kostos do të bazohet në një sërë kushtesh standarde, të tilla si vlerësimi i kursimeve të energjisë dhe çmimet themelore të energjisë dhe një parashikim paraprak i kostos. Përveç kësaj, ai do të përmbajë informacion mbi hapat që duhen ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve, informacionin e kontaktit të sporteleve me një-ndalesë dhe, aty ku është e nevojshme, për opsionet e mbështetjes financiare. Informacione të tjera për tema të ndërlidhura, të tilla si auditimet e energjisë ose stimujt e një natyre financiare ose të tjera dhe mundësitë financiare, ose këshilla se si të rritet qëndrueshmëria klimatike e ndërtesës, mund t'i jepet gjithashtu pronarit ose qiramarrësit të ndërtesës ose njësisë së ndërtesës.
13. Certifikata e performancës energjitike është e vlerfshme për 10 vite nga momenti i lëshimit për ndërtesat e përfunduara.
14. Për ndërtesat në fazë projekti, certifikata paraprake e performancës energjitike është e vlefshme deri në përfundimin e punimeve dhe e humbet vlefshmërinë para fillimit të procesit të kolaudimit të ndërtesës.

15. Kur një ndërtesë i është lëshuar një certifikatë e performancës energjitike nën nivelin C, pronarët e ndërtesave ftohen në një sportel me një-ndalesë për të marrë këshilla rinovimi për cilëndo nga sa më poshtë është më e hershme:
 - a) menjëherë pas skadimit të certifikatës së performancës energjitike të ndërtesës; ose
 - b) pesë vjet pas lëshimit të certifikatës së performancës energjitike.
16. Përditësimi i certifikatave të performancës energjitike realizohet lehtësisht përmes programeve kompjuterike të miratuar, pas çdo rekomandimi të zbatuar në përputhje me librezën e rinovimit.
17. Të dhënat që përfshihen në certifikatën e performancës energjitike:
 - a) një tregues numerik të energjisë primare të përdorur në kWh/(m².v);
 - b) tregues për kërkesat minimale të performancës energjitike;
 - c) tregues për kërkesat minimale të standardeve të performancës energjitike;
 - ç) tregues për kërkesat minimale për ndërtesat pa emetime;
 - d) tregues për ndërtesat “gati për GIGABIT”.
18. Procedurat dhe kushtet e certifikimit të performancës energjitike të ndërtesave dhe modeli, përmbajtja, dhe të dhënat e tjera që përfshihen në “Certifikatën e performancës energjitike”, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me propozimin e ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit e të zhvillimit të territorit.

Neni 16

Lëshimi i Certifikatës së performancës energjitike

1. Certifikimi i performancës energjitike është i detyrueshëm për:
 - a) të gjitha ndërtesat ose njësitë e ndërtesave, të cilat do të shiten ose do të jepen me qira;
 - b) të gjitha ndërtesat, të cilat do të projektohen, ndërtohen ose do t'i nënshtrohen rinovimit të konsiderueshëm;
 - c) të gjitha ndërtesat që janë në përdorim nga një institucion publik.
2. Certifikata e performancës energjitike bëhet e disponueshme vetëm në format digjital dhe është lehtësisht e printueshme nga pronarët e ndërtesave.
3. Detyrimet sipas pikës 1 nuk zbatohen për ndërtesat që disponojnë një certifikatë të performancës energjitike brenda periudhës së vlefshmërisë.
4. Kur ndërtesat ose njësitë e ndërtesave janë ndërtuar, kanë pësuar një rinovim të konsiderueshëm, ose janë shitur ose dhënë me qira, ose kur rinovohen kontratat e qirasë për ndërtesat ose njësitë e ndërtimit, certifikata e performancës energjitike i tregohet kandidatit qiramarrës ose blerës dhe i dorëzohet blerësit ose qiramarrësit.
5. Kur një ndërtesë shitet ose jepet me qira përpara ndërtimit ose rinovimit të konsiderueshëm, shitësit vendosin në dispozicion certifikatën e performancës energjitike paraprake e cila jep një vlerësim të performancës së ardhshme energjitike të ndërtesës; Në çdo rast, certifikata e performancës energjitike do të lëshohet më së voni pasi ndërtesa të jetë ndërtuar ose rinovuar dhe duhet të pasqyrojë rendimentin energjetik sipas gjendjes së ndërtuar.
6. Duke nisur nga viti 2026 të gjitha ndërtesat ose njësitë e ndërtesave që ofrohen për shitje ose me qira duhet të pajisen me certifikatën e performancës energjitike dhe treguesi i performancës energjitike dhe klasa e certifikatës së performancës energjitike të ndërtesës ose njësisë së ndërtesës, sipas rastit, të jenë deklaruar në reklamat online dhe offline, duke përfshirë në faqet e internetit të portalit të kërkimit të pronës.
7. Certifikatat e performancës energjitike lëshohen, ngarkohen dhe regjistrohen në bazën e të dhënave pa asnjë kosto shtesë.

8. Të gjitha certifikatat e performancës energjitike të lëshuara nga audituesit energjetik në ndërtesa ngarkohen nga këto të fundit në bazën e të dhënave për performancën energjitike të ndërtesave të përmendura në nenin 29. Ngarkimi duhet të përmbajë certifikatën e plotë të performancës energjitike, duke përfshirë të gjitha të dhënat e nevojshme të kërkuara për llogaritjen e performancës energjitike të ndërtesës.

Neni 17

Shfaqja e certifikatave të performancës energjitike

1. Ndërtesat e përdorura nga institucione publike të cilat janë të pajisura me certifikatën e performancës energjitike janë të detyruara ta shfaqin atë në një vend të dukshëm për publikun.
2. Ndërtesat jo-rezidenciale të cilat janë të pajisura me certifikatën e performancës energjitike janë të detyruara ta shfaqin atë në një vend të dukshëm për punonjësit dhe vizitorët, si p.sh. në anë të Certifikatës së Regjistrimit të Biznesit.
3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 përfshijnë vetëm detyrimin për të paraqitur klasin energjetik të ndërtesës dhe çdo përmbajtje tjetër e certifikatës së performancës energjitike, nuk është e detyrueshme të paraqitet.

KREU V

SISTEMET TEKNIKE NË NDËRTESTA DHE INSPEKTIMI

Neni 18

Shfrytëzimi i energjisë diellore në ndërtesa

1. Duke nisur nga viti 2026 të gjitha ndërtesat e reja projektohen duke optimizuar potencialin e tyre të shfrytëzimit të energjisë diellore në bazë të rrezatimit diellor të zonës dhe duke mundësuar instalimin e mëvonshëm me kosto efektive të teknologjive diellore.
2. Procedura për dhënien e lejeve të nevojshme për instalimin e sistemeve diellore do të funksionojë sipas ligjit përgjegjës për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme për impiantet që gjenerojnë energji elektrike dhe energji termike.
3. Me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për planifikimin e territorit, këshilli i ministrave miraton një skemë kombëtare për instalimin në ndërtesa të sistemeve që shfrytëzojnë energjinë diellore.
4. Skema e mësipërme do të aplikohet për çdo ndërtesë që plotëson kushtet e përshtatshmërisë dhe zbatueshmërisë së saj, nga pikëpamja teknike, ekonomike (kosto përfitim) dhe funksionale.
5. Skema sipas pikës 3 do të përfshijë:
 - a) nga data 31 Dhjetor 2026, të gjitha ndërtesat e reja publike dhe ndërtesat jo-rezidenciale me një sipërfaqe të dobishme më të madhe se 250 m²;
 - b) të gjitha ndërtesat publike ekzistuese me sipërfaqe të dobishme më të madhe se:
 - i. 2000 m², nga data 31 dhjetor 2027
 - ii. 750 m², nga data 31 dhjetor 2028
 - iii. 250 m², nga data 31 dhjetor 2030
 - c) nga data 31 dhjetor 2027, të gjitha ndërtesat ekzistuese jorezidenciale me sipërfaqe të dobishme më të madhe se 500 m², ku ndërtesa i nënshtrohet një rinovimi të konsiderueshëm ose një veprimi që kërkon një leje administrative për rinovimin e ndërtesës përfshirë punimet në çati ose instalimin e sistemeve teknike;
 - ç) nga data 31 dhjetor 2029, të gjitha ndërtesat e reja rezidenciale dhe,

- d) nga data 31 dhjetor 2029, në të gjitha vendpushimet e reja të mbuluara për mjete lëvizëse, të pozicionuar fizikisht pranë me ndërtesat.
6. Vendimi sipas pikës 3, do të përfshijë kriteret specifike që ndërtesat duhet të plotësojnë nga për të qenë pjesë e kësaj skemës si dhe ndërtesat që përjashtohen respektivisht aktivitetit dhe funksionit të tyre.
7. Skema përfshin të gjitha masat e nevojshme administrative, teknike dhe financiare për të mbështetur dhe lehtësuar instalimin e sistemeve që shfrytëzojnë energjinë diellore duke përfshirë dhe mundësitë për kombinimin e këtyre teknologjive me sistemet teknike ekzistuese në ndërtesa si dhe me sistemet e ngrohjes dhe ftohjes qëndrore.
8. Kompanitë e projektimit janë përgjegjëse për çdo problematikë që shfaqet lidhur me kapacitetin e pritshëm të prodhimit, mënyrës së instalimit si dhe me periudhën e kthimit të investimit dhe ndëshkohen me masë administrative sipas nenit kaq e aq në rastin e vërtetimit të shkeljes.

Neni 19 **Sistemet teknike në ndërtesa**

1. Kërkesat minimale për performancën energjitike në ndërtesa sipas nenit 9, përfshijnë kërkesa specifike për efikasitetin e sistemeve teknike që përdoren në ndërtesa të reja dhe në ndërtesa që do të nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.
2. Kërkesat specifike zbatohen për rinovimin, përmirësimin ose zëvendësimin e sistemeve teknike ose pjesëve të sistemeve teknike që përdoren në ndërtesa dhe janë të paktën në përputhje me nivelet e kostos optimale, sipas raportit më të fundit.
3. Kërkesat për sistemet teknike në ndërtesa përfshijnë të paktën:
 - a) Zbatimin e standardeve për garantimin e cilësisë së mjedisit të brendshëm me qëllim ruajtjen e mirëqënies së përdoruesve të ndërtesës;
 - b) Instalimin e aparaturave për matjen, kontrollin, monitorimin dhe rregullimin e cilësisë së ajrit të brendshëm për ndërtesat pa emetime jo-rezidenciale. Në ndërtesa jo-rezidenciale ekzistuese instalimi i këtyre aparaturave do të jetë i detyrueshëm kur ndërtesa i nënshtrohet një rinovimi të konsiderueshëm dhe është i zbatueshëm nga pikëpamja teknike dhe ekonomike
 - c) Kushtet për instalimin e sistemeve automatike të ndriçimit
 - ç) Kërkesa të tjera specifike respektivisht tipologjisë së ndërtesës.
4. Instalimet e sistemeve teknike ose ndryshimet e bëra në sistemet teknike duhet të nënshtrohen vlerësimit të performancës energjitike. Rezultatet e këtij vlerësimi duhet të vihen në dispozicion pronarit të ndërtesës dhe të ngarkohen në bazën e të dhënave për performancën energjitike.
5. Ministri përgjegjës për energjinë harton skemën për nxitjen e përdorimit të sistemeve teknike me efikasitet të lartë energjitike në ndërtesa e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Skema sipas pikës 5 konsideron të paktën sistemet:
 - a) alternative me efikasitet të lartë energjie sipas nenit 20;
 - b) për ngrohjen dhe kondicionimin e ajrit;
 - c) e kontrollit dhe të automatizimit;
 - ç) e ujit të ngrohtë sanitar;
 - d) e ndriçimit;
 - dh) e karikimit të makinave, si dhe
 - e) e depozitimit të energjive të rinovueshme në ndërtesa.
7. Skema ka si synim kryesor zëvendësimin e sistemeve teknike që shfrytëzojnë energjinë e

përfutur nga burime jo të rinovueshme energjie si dhe aplikimin e teknologjive me efikasitet të lartë energjie në plotësimin e kërkesave minimale të komfortit dhe cilësisë së mjedisit të brendshëm.

Neni 20

Sistemet teknike alternative me efikasitet të lartë energjike

1. Kur projektohet një ndërtesë e re ose kur një ndërtesë duhet t'i nënshtrohet një rinovimi të konsiderueshëm, subjekti zhvillues, konsideron aplikimin e sistemeve me performancë të lartë energjike si më poshtë:
 - a) sistemet e decentralizuara të furnizimit me energji që shfrytëzojnë burime të rinovueshme të energjisë;
 - b) sistemet koogjeneruese, që realizojnë prodhimin e kombinuar të energjisë termike dhe të energjisë elektrike ose mekanike;
 - c) sistemet me pompa nxehtësie, të cilat ndryshojnë dhe transferojnë rrjedhën natyrale të energjisë termike, nga mjedisi i jashtëm te ndërtesat ose njësitë e ndërtesave dhe anasjelltas, nëse kërkohet një gjë e tillë;
 - ç) sistemet e ngrohjes dhe ftohjes së përqendruar, veçanërisht ato që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie për ndërtesa ose blloqe ndërtesash.
2. Nëse aplikimi për leje ndërtimi/ punimesh/ administrative përfshinë vetëm zëvendësim ose rinovimin e sistemit teknik të ndërtesës, paraprakisht duhet të kryhet vlerësimi i mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me efikasitet të lartë energjie sipas pikës 1.
3. Dëshmitë e vlerësimit të fizibilitetit të përdorimit të sistemeve alternative të mësipërme shoqërojnë certifikatën e performancës energjike për çdo ndërtesë dhe janë të disponueshme për inspektim.
4. Forma dhe përmbajtja e dëshmimeve të vlerësimit të fizibilitetit të përdorimit të sistemeve alternative me efikasitet të lartë energjike miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për energjinë me propozimin e agjencisë për efikasitetin e energjisë.
5. Nëse analiza e mundësisë së përdorimit të sistemeve alternative me efikasitet të lartë energjie nuk kryhet nga pronari i ndërtesës, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, atëherë duhet të zbatohen masat administrative në përputhje me parashikimet e nenit 34, të këtij ligji.

Neni 21

Libreza e rinovimit të ndërtesës

1. Ministria përgjegjëse për energjinë harton një skemë për librezat e rinovimit të ndërtesave që ju mundëson pronarëve të ndërtesave një pasqyrë gjithpërfshirëse mbi mundësitë, hapat dhe informacionin e nevojshëm për të realizuar një rinovim të thelluar me qëllim, rritjen e performancës energjike të ndërtesës duke synuar tjetërsimin në një ndërtesë pa emetime dhe me konsum energjetik pothuajse zero.
2. Skema e përmendur në pikën 1 do të përzgjidhet vullnetarisht deri në fund të vitit 2028 nga pronarët e ndërtesave dhe njësitë të ndërtesës dhe do të jetë e detyrueshme pas këtij viti për çdo ndërtesë ekzistuese që do të nënshtrohet një rinovimi të konsiderueshëm, dhe për çdo ndërtesë që do të shitet ose do të jepet me qera.
3. Libreza e rinovimit lëshohet nga një auditues i certifikuar së bashku me certifikatën e performancës energjike, në formë digjitale të përshtatshme për printim.
4. Libreza e rinovimit të ndërtesës përfshinë në mënyrë të detajuar të gjitha hapat e nevojshme për transformimin e ndërtesës ekzistuese në një ndërtesë pa emetime dhe me

konsum energjetik pothuajse zero.

5. Libreza e rinovimit të ndërtesës ngarkohet nga audituesit energjetik në bazën kombëtare të të dhënave për performancën energjitime të ndërtesave, të ngritur në përputhje me nenin 29 dhe mund të aksesohet lehtësisht nga palët e interesuara.
6. Vendimi i përmendur në pikën 1, përcakton formën, kushtet, kriteret, informacionin dhe të dhëna të tjera që duhet të përmbajë librezat për rinovimin e ndërtesës e cila propozohet nga ministri përgjegjës për energjinë dhe miratohet me vendim të këshillit të ministrave.

Neni 22

Inspektimi i sistemeve teknike

1. Duke filluar nga 1 Janari i vitit 2026 sistemet teknike në ndërtesa do të inspektohen në intervale të caktuara dhe do të përfshijnë sistemet e ngrohjes, sistemet e ventilimit dhe sistemet e kondicionimit të ajrit, duke përfshirë çdo kombinim të tyre, me një fuqi nominale efektive mbi 70 kW. Vlerësimi efektiv i sistemit do të bazohet në shumën e prodhimit të vlerësuar të gjeneratorëve të nxehtësisë dhe impianteve ftohës.
2. Sistemet teknike sipas pikës 1 do të inspektohen të paktën çdo tre vjet ndërsa sistemet me gjeneratorë nxehtësie ose impiante ftohës me fuqi nominale efektive më shumë se 290 kW do të inspektohen të paktën çdo 2 vjet.
3. Inspektimi dhe raportimi i sistemeve teknike realizohet vetëm nga Audituesit energjetik në procese industriale të certifikuar sipas ligjit përgjegjës për eficientësinë energjitime dhe Inspektorët e sistemeve teknike të certifikuar sipas këtij ligji.
4. Inspektimi përfshin vlerësimin e gjeneratorit ose gjeneratorëve, pompave të qarkullimit dhe, sipas rastit, përbërësve të sistemeve të ventilimit, sistemeve të shpërndarjes së ajrit dhe ujit, sistemeve të balancimit hidronik dhe sistemeve të kontrollit.
5. Inspektimi duhet të përfshijë një vlerësim të eficientësisë energjitime dhe përmasimit të gjeneratorit ose gjeneratorëve të ngrohjes dhe impianteve të ftohjes dhe të përbërësve kryesorë të tij krahasuar me kërkesat e ndërtesës dhe do të marrë në konsideratë aftësitë e sistemit për të optimizuar performancën e tij në kushte tipike ose mesatare të funksionimit, duke përdorur teknologjitë e disponueshme me eficientësi të lartë energjitime dhe në kushtet e ndryshueshme për shkak të ndryshimeve të përdorimit.
Aty ku është e nevojshme, inspektimi do të vlerësojë fizibilitetin e sistemit për të operuar në kushte të ndryshme dhe në temperatura eficientë, të tilla si në temperaturë të ulët për sistemet e ngrohjes me bazë uji, duke përfshirë projektimin e fuqisë termike në dalje dhe kërkesat e temperaturës dhe rrjedhës, duke siguruar funksionimin e sigurt të sistemit. Inspektimi, aty ku është e nevojshme, do të përfshijë një vlerësim bazë të fizibilitetit për të reduktuar përdorimin në vend të lëndëve djegëse fosile, për shembull duke integruar energjinë e rinovueshme, duke ndryshuar burimin e energjisë ose duke zëvendësuar ose rregulluar sistemet ekzistuese.
Kur është instaluar një sistem ventilimi, do të vlerësohen edhe përmasat e tij dhe aftësitë e tij për të optimizuar performancën e tij në kushte tipike ose mesatare të funksionimit të rëndësishme për përdorimin specifik dhe aktual të ndërtesës.
6. Sistemet teknike të ndërtesave që mbulohen në mënyrë eksplicite nga një kriter i miratuar i performancës energjitime ose një marrëveshje kontraktuale që specifikon një nivel të dakordësuar të përmirësimit të eficientësisë energjitime, siç është kontraktimi i performancës energjitime, ose që operohen nga një operator komunal ose rrjeti dhe për këtë arsye i nënshtrohen monitorimit të performancës masat nga ana e sistemit, do të përjashtohen nga kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1, me kusht që ndikimi i përgjithshëm i një qasjeje të tillë të jetë i barabartë me atë që rezulton nga paragrafi 1.
7. Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrisë përgjegjëse për energjinë miraton aktin nënligjor i cili përcakton përmbajtjen, metodat, kushtet dhe afatet për inspektimin e

- sistemeve teknike në ndërtesa.
- Vendimi i mësipërm përcakton skema inspektimi ose masa alternative si mjetet digjitale dhe listat kontrolluese për të vërtetuar se punimet e dorëzuara të ndërtimit dhe rinovimit plotësojnë performancën e projektuar energjitike dhe janë në përputhje me kërkesat minimale të performancës energjitike të përcaktuara në kodet e ndërtimit ose rregulloret ekuivalente.
 - Një analizë e përmbledhur e skemave të inspektimit dhe rezultateve të tyre do të përfshihet si një aneks i planit kombëtar të rinovimit të ndërtesave të përmendur në nenin 5.

Neni 23

Raporte mbi inspektimin e sistemeve të ngrohjes, sistemeve të ventilimit dhe sistemeve të ajrit të kondicionuar

- Pas çdo inspektimi të sistemit të ngrohjes, sistemit të ventilimit ose sistemit të ajrit të kondicionuar do të lëshohet një raport inspektimi. Raporti i inspektimit duhet të përmbajë rezultatin e inspektimit të kryer në përputhje me nenin 22 dhe të përfshijë rekomandime për përmirësimin me kosto efektive të performancës energjitike të sistemit të inspektuar.

Këto rekomandime mund të bazohen në një krahasim të performancës energjitike të sistemit të inspektuar me atë të sistemit më të mirë të mundshëm të disponueshëm, duke përdorur teknologji të kursimit të energjisë, dhe një sistem të llojit të ngjashëm për të cilin të gjithë komponentët përkatës arrijnë nivelin e performancës energjitike të kërkuar nga ligji në fuqi. Rekomandimet, sipas rastit, do të përfshijnë rezultatet nga vlerësimi bazë i fizibilitetit për të reduktuar përdorimin në vend të lëndëve djegëse fosile.

Raporti i inspektimit duhet të tregojë çdo çështje sigurie që është zbuluar gjatë inspektimit. Megjithatë, autori i raportit nuk do të konsiderohet si përgjegjës në lidhje me zbulimin ose treguesin e ndonjë çështjeje të tillë sigurie.

- Raporti i inspektimit i dorëzohet pronarit ose qiramarrësit të ndërtesës ose njësisë së ndërtesës.
- Raporti i inspektimit do të ngarkohet në bazën kombëtare të të dhënave për performancën energjitike të ndërtesave, sipas nenit 29.

KREU VI

EKSPERTËT E PAVARUR DHE SISTEMI I MBIKQYRJES

Neni 24

Ekspertë të pavarur

- Certifikimi i performancës energjitike të ndërtesave, hartimi dhe plotësimi i librezave të rinovimit dhe inspektimi i sistemeve të ngrohjes, sistemeve të ventilimit dhe sistemeve të ajrit të kondicionuar kryhen në mënyrë të pavarur nga ekspertë të pavarur dhe të certifikuar, dhe operojnë në cilësi të vetëpunësuar ose të punësuar nga organet private ose ndërmarrjet private.
- Ekspertët e pavarur certifikohen përputhje me vendimin sipas pikës 4 në vijim.
- Për qëllim të këtij neni ekspertët e pavarur certifikohen si:
 - Auditues Energjetik për ndërtesa;
 - Inspektor për sistemet teknike në ndërtesa.
- Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton

- procedurën, kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave, sipas përmbajtjes së pikës 4 të këtij neni, përcakton:
 - a) kategoritë dhe kërkesat minimale të kualifikimit të ekspertëve të pavarur së bashku me autorizimin e tyre për të kryer shërbimet energjitike në objekte të ndryshme;
 - b) kriteret për përzgjedhjen e institucioneve të miratuara të edukimit dhe/ose trajnimit, të cilat janë të autorizuar nga ministria përgjegjëse për energjinë, të kryejnë trajnime, duke përfshirë kualifikimet minimale, kapacitetet dhe objektet që këto institucione duhet të zotërojnë;
 - c) një listë të trajnimeve të detyrueshme profesionale që duhet të përfshijnë të paktën trajnimin për legjislacionin përkatës kombëtar, standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e auditimit energjetik dhe menaxhimit energjetik, trajnime teknike për teknikat e auditimit energjetik, teknikat e analizës së kostove, teknikat e shkrimit të një raporti auditimi;
 - ç) parashikimin e kryerjes së testimeve përfundimtare, vlerësimin e rezultateve dhe certifikimin e atyre që kanë përfunduar me sukses programet e trajnimit;
 - d) rregullat dhe kriteret për ngritjen e komisioneve të testimit;
 - dh) rregulla procedurale për njësimin e certifikatave të ekspertëve të pavarur të lëshuara nga institucione të huaja;
 - e) kodin e sjelljes së ekspertëve të pavarur;
 - ë) raportimet e detyrueshme;
 - f) metodat e procedurat për kontrollin e cilësisë së auditimeve energjitike dhe audituesve energjetikë, bazuar në kontrollin të paktën të një përqindjeje të konsiderueshme statistikore të raporteve të auditimit energjetik që ata realizojnë;
 - g) vendosjen e kriterëve minimale transparente dhe jodiskriminuese për të garantuar cilësinë e lartë të shërbimeve energjitike të ofruara nga ekspertët e pavarur;
 - gj) arsyet dhe procedurat për vendosjen e masave administrative, për shkak të performancës së dobët ose shkeljes së kodit të sjelljes.
 6. Agjencia dhe ministria përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, publikojnë listën e ekspertëve të certifikuar në faqen e tyre të internetit.
 7. Ekspertët e certifikuar regjistrojnë në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie kryerjen e shërbimit respektivisht certifikatës që zotërojnë.
 8. Ekspertët e pavarur nuk kryejnë shërbime energjitike respektivisht certifikimit të tyre në:
 - a) shoqëri në të cilat zotërojnë aksione ose kuota;
 - b) shoqëri në të cilën janë anëtar të një organi drejtues ose janë të punësuar nga personi të cilit i kërkohet të realizojë secilin nga shërbimet energjitike për të cilin ato janë certifikuar;
 - c) rezultojnë të afërm të shkallës së dytë me personat që ju ofrojnë secilin nga shërbimet energjitike për të cilin ato janë certifikuar;
 - ç) çdo rast tjetër të parashikuar nga ligjislacioni në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.
 - d) objekte tek të cilat kanë gjeneruar certifikatat paraprake të performancës energjitike.
 9. Ministria dhe agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë vendosin në dispozicion të palëve të interesuara informacionin mbi trajnimet dhe certifikimet e disponueshme.

Neni 25

Mbikëqyrja e ekspertëve të performancës energjitike të ndërtesave

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton procedurën, kriteret, kushtet, kërkesat dhe autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e

- shërbimeve të kryera nga ekspertët e pavarur.
2. Vendimi sipas pikës 1 përcakton bazat për krijimin e sistemeve të pavarura të kontrollit për certifikatat e performancës energjitike, sistemet e pavarura të kontrollit për librezat e rinovimit dhe raportet mbi inspektimin e sistemeve të ngrohjes, sistemeve të ventilimit dhe sistemeve të ajrit të kondicionuar.
 3. Procesi i mbikqyrjes realizohet nga ekspertët e certifikuar nga ministria përgjegjëse për energjinë sipas procedurës së parashikuar në pikën 4 të nenit 24, të cilët janë punonjës prej më shumë se 2 vitesh në institucionet publike që ngarkohen me përgjegjësinë e realizimit të procesit të mbikqyrjes.
 4. Vendimi sipas pikës 1 përcakton në mënyrë të detajuar kriteret dhe kushtet për klasifikimin e shkeljeve të konstatuara gjatë procesit të mbikqyrjes në:
 - a) Shkelje – e cila shoqërohet me masë administrative;
 - b) Shkelje e rëndë – për të cilën ekspertit të pavarur përveç masës administrative sipas pikës a) i revokohet certifikata për një periudhë 1 vjeçare.
 5. Ekspertëve të pavarur, të cilëve iu është revokuar certifikata, sipas pikës 3(b), të këtij neni, kanë të drejtë të aplikojnë për certifikatë të re jo më herët se tre vjet nga data e marrjes së vendimit të mësipërm. Në rast se të njëjtit person i revokohet certifikata për herë të dytë, atëherë ky person nuk ka më të drejtë të aplikojë për certifikatë.
 6. Ekspertët e pavarur janë të detyruar të vendosin në dispozicion të autoritetit mbikqyrës të gjithë materialin dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e procesit të mbikqyrjes së:
 - a) Certifikatës së performancës energjitike të ndërtesës;
 - b) Librezës së rinovimit të ndërtesës;
 - c) Raportit të inspektimit të sistemit teknik të ndërtesës.
 7. Ekspertët e pavarur që nuk vendosin në dispozicion të autoritetit mbikqyrës materialin sipas pikës 6, zbatohen masat e parashikuara sipas shkronjës “b”, pikës 4 të këtij neni.

KREU VII

MODELI SHEMBULLOR I NDËRTESAVE PUBLIKE

Neni 26

Rinovimi i ndërtesave publike

1. Duke filluar nga data 1.4.2022, sektori publik ngarkohet me zbatimin e objektivit që 3% (tre për qind) e sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike me ngrohje dhe/ose ftohje, në pronësi dhe të zëna nga organet e qeverisjes qendrore, dhe 2% (dy për qind) e sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave të tjera publike të rinovohet çdo vit për të përmbushur kërkesat minimale për performancën e energjisë.
2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton vendimin që përcakton sasinë në përqindje të sipërfaqes së stokut të ndërtesave publike për t’u rinovuar çdo vit kundrejt sipërfaqes totale të stokut të ndërtesave publike. Ky vendim i Këshillit të Ministrave përfshin:
 - a) një metodologji të veçantë që përdoret për përcaktimin e sipërfaqes së stokut dhe llogaritjen e përqindjes përkatëse të ndërtesave publike;
 - b) përcaktimin e sipërfaqes totale të ndërtesave publike;
 - c) tipologjinë e ndërtesave që kërkohet të respektojnë kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe të atyre të përjashtuara nga ky detyrim;
 - ç) zbatueshmërinë mbi ndërtesat e shfrytëzuara nga organet e qeverisjes qendrore, vendore dhe ato të vartësisë; dhe

- d) masa të tjera, të cilat zbatohen për të mundësuar rinovimin tërësor të ndërtesave të organeve të qeverisjes qendrore.
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave, i përmendur në pikën 2 të këtij neni:
 - a) përcakton si objektiv ndërtesat e organeve të qeverisjes qendrore me performancën më të ulët të energjisë, të cilat kanë përparësi lidhur me masat për efikasitetin e energjisë, kur kjo është e mundur si nga pikëpamja e kostos efektive, ashtu edhe teknikisht e realizueshme;
 - b) hartohet në përputhje me përmbajtjen e planit të veprimit afatgjatë të përshkruar në nenin 9/3 të këtij ligji.
4. Ministri nëpërmjet agjencisë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë miraton e publikon inventarin e ndërtesave me ngrohje dhe/ose ftohje të organeve të qeverisjes qendrore, me sipërfaqe të përgjithshme të shfrytëzueshme mbi 250 m². Inventari përfshin:
 - a) sipërfaqen totale të kateve në metra katrorë; dhe
 - b) performancën aktuale të energjisë së secilës ndërtesë ose të dhënat përkatëse që lidhen me energjinë, duke përcaktuar objektivin e performancës.
5. Me qëllim përgatitjen e inventarit, ministri, përmes agjencisë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, u dorëzon një kërkesë për dhënien e informacionit të nevojshëm sipas pikës 3 të këtij neni subjekteve përkatëse të sektorit publik, të cilat janë të detyruara të japin informacionin e kërkuar për stokun brenda afatit të përcaktuar në kërkesë.”
6. Objektivat e përcaktuara në pikën 1, përfshihen në Planin Kombëtar të Rinovimit të Ndërtesave në përputhje me nenin 5.

Neni 27

Administratorët e energjisë

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, në çdo ndërtesë publike nominohet një administrator energjie i cili ndër të tjera, do të jetë përgjegjës për të zbatuar masat e ruajtjes së energjisë me qëllim reduktimin e konsumit energjetic për ndërtesën në të cilën është përgjegjës.
2. Administratorët e energjisë janë përgjegjës për:
 - a) raportimin mujor të faturave të energjisë elektrike dhe burimeve të tjera energjitike që përdoren në ndërtesë;
 - b) raportimin e orëve gjatë të cilave funksionon sistemi i ngrohjes/ftohjes së ndërtesës;
 - c) zbatimin e masave që lidhen me ruajtjen e energjisë në ndërtesa;
 - ç) detyra të tjera të caktuara sipas vendimit të këshillit të ministrave të pikës 4.
3. Administratorët e energjisë caktohen nga titullari i institucionit dhe qëndrojnë në komunikim të vazhdueshëm me nëpunësit e Agjencisë dhe Ministrinë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë.
4. Këshilli i ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, harton vendimin që përcakton përgjegjësitë, kushtet, kriteret dhe vlerën e shpërblimit për administratorët e energjisë.
5. Në përputhje me pikën 4 administratorët e energjisë raportojnë në mënyrë periodike sipas formatit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.

KREU VIII

BAZA E TË DHËNAVE, INFORMACIONI DHE MASAT MBËSHTETËSE

Neni 28

Disponueshmëria e të dhënave dhe informacionit

1. Ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkëpunim me Agjencinë përgjegjëse për Kadastrën, për eficientë si dhe Furnizuesin e Shërbimit Universal hartojnë vendimin për krijimin e bazës kombëtare të të dhënave energjitike të ndërtesave i cili miratohet nga Këshilli i ministrave.
2. Çdo ndërtesë e re që aplikon për leje ndërtimi (në fazë projekti), shfrytëzimi (në fazë projekti) si dhe çdo ndërtesë ekzistuese pajiset me një ndërfaqe ku pasqyrohet i gjithë informacioni i disponueshëm për performancën energjitike.
3. Vendimi sipas pikës 1 përmban të paktën të dhënat e mëposhtme mbi:
 - a) performancën energjitike të ndërtesës, të elementëve të ndërtesës si dhe të sistemeve teknike;
 - b) sistemet e automatizimit dhe kontrollit;
 - c) matësit e energjisë dhe të dhënat e konsumit energjetik;
 - ç) paisje të tjera për matjen dhe kontrollin;
 - d) pikat e karikimit të ndodhura brenda ose pranë ndërtesës;
 - dh) ndërlidhjet inteligjente përmes IoT dhe raportim në kohë reale;
 - e) të dhëna të tjera.
4. Informacioni i mbledhur në bazën kombëtare të të dhënave për performancën energjitike të ndërtesave është pa pagesë për pronarët ose qiramarrësit e ndërtesave ndërsa për palë të tjera të interesuara, si institucionet financiare, agregatorët, furnizuesit e energjisë do të mund të aksesojnë të dhënat përmes pagesës së miratuar në vendimin sipas pikës 1.
5. Aksesimi i të dhënave do të mundësohet në përputhje me rregullat për mbrojtjen e konfidencialitetit.

Neni 29

Baza e të dhënave për performancën e energjisë në ndërtesa

1. Këshilli i ministrave krijon dhe miraton një bazë të dhënash kombëtare për performancën energjitike të ndërtesave, e cila lejon mbledhjen e të dhënave mbi performancën energjitike të ndërtesave individuale dhe mbi performancën e përgjithshme energjitike të stokut kombëtar të ndërtesave.
Baza e të dhënave lejon mbledhjen e të dhënave nga të gjitha burimet përkatëse në lidhje me certifikatat e performancës energjitike, inspektimet, librezën e rinovimit, treguesin digjital të ndërtesës dhe konsumin e llogaritur ose të matur të energjisë së ndërtesave.
2. Të dhënat e grumbulluara të stokut të ndërtesave do të vihen në dispozicion të publikut, në mënyrë anonime dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e të dhënave. Të dhënat e ruajtura duhet të jenë të lexueshme nga makineritë dhe të aksesueshme nëpërmjet një ndërfaqe të përshtatshme digjitale.
3. Certifikata e performancës energjitike e ngarkuar në bazën e të dhënave për performancën energjitike të ndërtesave aksesohet lehtësisht dhe pa pagesë nga pronarët, qiramarrësit dhe menaxherët e ndërtesave dhe për institucionet financiare në lidhje me ndërtesat në portofolet e tyre të investimeve dhe huadhënies, dhe, me leje nga pronari, gjithashtu ekspertë të pavarur. Për ndërtesat e ofruara me qira ose shitje, pronarët e ndërtesave janë të detyruar të lejojnë aksesimin e certifikatës së plotë të performancës energjitike në bazën e të dhënave për qiramarrësit ose blerësit e mundshëm.
4. Informacioni i mbledhur në bazën e të dhënave kombëtare vendoset në dispozicion të publikut përsa i përket stokut kombëtar të pajisur me certifikatën e performancës energjitike dhe të dhëna të tjera mbi performancën energjitike duke përfshirë konsumin energjetik dhe kur është e mundur, PNG-në gjatë ciklit jetësor për ndërtesat e vlerësuara. Informacioni publik përditësohet të paktën dy herë në vit.
5. Informacioni sipas këtij neni transferohet të paktën 1 herë në vit tek Sekretariati i

Komunitetit të Energjisë sipas formatit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.

6. Në vendimin për krijimin e bazës së të dhënave përcaktohet në mënyrë të detajuar:
 - a) institucionin administrues të bazës së të dhënave shtetërore;
 - b) të dhënat parësore dhe dytësore;
 - c) dhënësin/dhënësit e informacionit;
 - ç) ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave;
 - d) nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara.
7. Sipas kërkesës, institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore, vendos në dispozicion informacionin anonim ose të përmbledhur për të gjithë institucionet publike kërkimore/ shkencore si dhe për institutin përgjegjës për statistikat kombëtare.

Neni 30 **Stimujt financiarë**

1. Këshilli i ministrave miraton skema financiare për të mbështetur dhe adresuar barrierat e tregut për:
 - a. Planin kombëtar për rinovimin e ndërtesave sipas nenit 5;
 - b. Rinovimin e stokut kombëtar të ndërtesave publike sipas nenit 26;
 - c. Auditimin dhe certifikimin e ndërtesave sipas nenit 16;
 - d. Zëvendësimin e sistemeve teknike që shfrytëzojnë lëndë djegëse fosile me sisteme alternative me efikasitet të lartë energjitike që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie në përputhje të raporteve të inspektimit të sistemeve teknike në ndërtesa sipas pikës 7 të nenit 19;
 - e. Zhvillimin e infrastrukturës për lëvizshmëri të qëndrueshme sipas nenit 14.
2. Vendimi sipas pikës 1 përcakton në mënyrë të detajuar mënyrën e funksionimit të skemës, burimin e financimit, institucionin përgjegjës për administrimin e skemës si dhe kushtet, kategoritë dhe kërkesat për përfituesit, të drejtat dhe detyrimet si dhe elementë të tjerë të nevojshëm për aplikimin e masave mbështetëse.
3. Udhëzimet, formularët e aplikimit, rregullorja si dhe organizimi i fushatës informuese për të gjithë palët e interesuara do të miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë me propozimin e institucionit përgjegjës për administrimin e skemës.
4. Skema e financimit mund të jetë e llojit:
 - a. Grant i cili mbulon një përqindje optimale të një vlere totale investimi të llogaritur.
 - b. kredi e butë,
 - c. paguaj sa kursen ose kontraktim i performancës energjitike.
5. Fondi i vendosur në dispozicion për mbështetjen e konsumatorëve privat sipas shkronjës b) dhe c) do të jetë i kthyeshëm të paktën në vlerën 100%, pavarësisht llojit të financimit të përzgjedhur dhe i shpërndarë në kohë për të gjithë jetëgjatësinë e përcaktuar të investimit.
6. Për ndërtesat me shumë njësi banimi (p.sh. ndërtesat me shumë apartamente) kourumi i nevojshëm për të aplikuar dhe proceduar me realizimin e skemës së mbështetjes është 60% e pronarëve të njësisve të banimit.
7. Gjatë rinovimit të ndërtesave do të merren parasysh në çdo rast qëndrueshmëria sizmike, mbrojtja nga zjarri dhe aksesin në ndërtesë të personave me aftësi të kufizuara.
8. Ministri përgjegjës për energjinë, realizon një analizë të detajuar mbi mundësinë e heqjes së TVSH dhe taksave të tjera për disa ose të gjithë elementet ndërtimore ose pajisjet që përfshihen në këtë ligj dhe e propozon për miratim në këshillin e ministrave.
9. Çdo institucion publik dhe ndërmarrje shtetërore duke përfshirë njësitë e qeverisjes vendore, operatorët e sistemit të shpërndarjes, etj., mundësojnë dhënien e lejeve sipas

fushës së përgjegjësive me procedurë të përshpejtuar për çdo përfitues të skemave të financimit.

Neni 31

Fondi i efikasitetit të energjisë

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji Fondi shqiptar i Zhvillimit përfshin në buxhetin e vitit pasardhës zërin me emërtim “programe zhvillimi për efikasitetin e energjisë”.
2. Fondi financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera financimi jashtë Buxhetit të Shtetit, përfshirë burimet e financimeve të huaja, nëpërmjet programeve apo projekteve të ndryshme për promovimin e efikasitetit dhe kursimit të energjisë.
3. Për arritjen e objektivave të efikasitetit të energjisë, Fondi mbështetet në parimet e vetëfinancimit, transparencës në administrimin e pasurisë, të trajtimit të barabartë të të gjithë përfituesve të fondit, partneritetit dhe bashkëpunimit me sektorin privat për bashkëfinancimin e projekteve të investimeve për efikasitetin e energjisë.
4. Forma e përfitimit të financimit prej programit të fondi për efikasitetin e energjisë rregullohet përmes skemave të financimit sipas nenit 31.

Neni 32

Sportelet me një ndalesë për performancën energjitike të ndërtesave

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Agjencia dhe ministria përgjegjëse për efikasitetin energjitike krijojnë sportelet me një ndalesë në në godinat e tyre qendrore për të ofruar asistencë administrative, teknike, dhe informacion mbi skemat e financimit, për performancën energjitike të ndërtesave për të gjithë aktorët e përfshirë në rinovimin e ndërtesave.
2. Sportelet e krijuara sipas pikës 1, pajisen me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të kryer të gjitha shërbimet në distancë dhe pa praninë e palëve të interesuara në vendodhje.
3. Duke filluar nga viti 2026, njësitë e qeverisjes vendore krijojnë sportele me një ndalesë (të paktën 1 për çdo bashki) për të njëjtin qëllim.
4. Sportelet me një-ndalesë të krijuara sipas paragrafit të mësipërm duhet:
 - a) të sigurojë informacione të thjeshta mbi mundësitë dhe zgjidhjet teknike dhe financiare për familjet, NVM-të dhe organet publike;
 - b) të japë këshilla të pavarura për performancën energjitike të ndërtesave dhe mund të shoqërojë programet e integruara të rinovimit të rretheve;
 - c) ofrojnë shërbime të dedikuara për familjet në nevojë, njerëzit e prekur nga varfëria energjitike dhe njerëzit në familje me të ardhura të ulëta;
 - ç) të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse për të gjitha familjet, me fokus të veçantë në familjet e prekura nga varfëria energjitike dhe në ndërtesat me performancën shumë të ulët, si dhe për kompanitë dhe instaluesit e akredituar që ofrojnë shërbime të rinovimit, të përshtatura me tipologjitë e ndryshme të banesave dhe shtrirjen gjeografike, dhe ofron mbështetje që mbulon faza të ndryshme të projektit të rinovimit.
5. Ministri përgjegjës për energjinë harton udhëzimin për funksionimin e sporteleve me një ndalesë për performancën energjitike të ndërtesave.

Neni 33

Informacion

1. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë harton strategjinë për fushatën e informimit dhe trajnimit të palëve të interesuara mbi masat, alternativat, mekanizmat e financimit,

- përfitimet dhe ndërgjegjësimin lidhur me efikasitetin energjitike.
2. Fushatat e informimit dhe trajnimit për përmirësimin e efikasitetit energjitike përfshinë të paktën:
 - a) pronarët dhe qiramarrësit e ndërtesave ose njësisve të ndërtesave;
 - b) aktorët e tjerë të tregut të ndërtesave si kopmanitë e ndërtimit ose shitjes së ndërtesave;
 - c) njësitë e qeverisjes vendore dhe rajonale, komunitetet e energjisë si dhe familjet e cënushme dhe familjet që jetojnë në varfëri energjitike;
 - ç) organizatat e shoqërisë civile dhe administratorët e ndërtesave;
 - d) administratorët e energjisë dhe ekspertët e pavarur të energjisë, etj.
 3. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë përgatit udhëzimet dhe trajnimet e nevojshme për palët e detyruara dhe palët e interesuara nga ky ligj të cilat theksojnë rëndësinë e përmirësimit të performancës energjitike dhe që lehtësojnë marrjen në konsideratë të përmirësimeve optimale në efikasitetin energjitike, reduktimin e gazeve me efekt serrë, përdorimin e burimeve të rinovueshme energjitike si dhe përdorimin e ngrohjes dhe ftohjes qendrore gjatë planifikimit, projektimit, ndërtimit dhe rinovimit të zonave industriale dhe rezidenciale.
 4. Udhëzime dhe trajnime të tilla mund të adresojnë gjithashtu përmirësimet strukturore, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, sigurinë nga zjarri, rreziqet që lidhen me aktivitetin intensiv sizmik, heqjen e substancave të rrezikshme duke përfshirë asbestin, emetimet e ndotësve të ajrit (përfshirë grimcat e imëta), cilësinë e mjedisit të brendshëm dhe aksesin në ndërtesa për personat me aftësi të kufizuara.
 5. Strategjia për fushatën e informimit sipas pikës 1 miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.
 6. Agjencia për efikasitetin e energjisë raporton në mënyrë periodike pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë mbi impaktin dhe përfshirjen e paleve të interesuara gjatë fushatave dhe trajnimeve të organizuara prej tyre.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 34 Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
 - a) për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në pikën 1 dhe pikën 6, të nenit 16, të këtij ligji, subjekti, që ka në pronësi apo përgjegjësi administrimi ndërtesën, dënohet me gjobë në masën 250 lekë/m² (sipërfaqe bruto), ndërsa subjektet që janë të përfshira në reklamimin e pronave online ose jo, dënohen me gjobë në masën 200'000.00 lekë.
 - b) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikën 8 të nenit 16 dhe në pikën 5 të nenit 21 të këtij ligji, subjektet dënohen me gjobë në masën 500'000.00 lekë;
 - c) për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në pikën 1 dhe pikën 2, të nenit 17, të këtij ligji, subjekti, që ka në pronësi apo përgjegjësi administrimi ndërtesën, dënohet me gjobë në masën 30'000.00 lekë;
 - d) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 8 të nenit 18 të këtij ligji, subjekti projektues dënohet me gjobë në masën 300'000.00 lekë;
 - e) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikën 2 të nenit 19 të këtij ligji, subjekti dënohet me gjobë në masën 400'000.00 lekë;
 - f) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të nenit 22 të këtij ligji,

- subjekti dënohet me gjobë në masën 100'000.00 lekë dhe 200'000.00 lekë;
- g) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të nenit 23 të këtij ligji, subjekti dënohet me gjobë në masën 1'000'000.00 lekë;
 - h) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikën 7 dhe 8 të nenit 24 të këtij ligji, subjekti dënohet me gjobë në masën 1'000'000.00 lekë;
 - i) për shkekljet sipas pikës 4(a) të nenit 25, ekspertët dënohen me gjobë në masën 1'000'000.00 lekë;
 - j) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në nenin 20 të këtij ligji, subjekti dënohet me gjobë në masën 300'000.00 lekë;
 - k) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikën 4 dhe 5 të nenit 27 të këtij ligji, subjekti dënohet me gjobë në masën 5'000.00 lekë;
 - l) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikën 9 dhe 5 të nenit 27 të këtij ligji, subjekti dënohet me gjobë në masën 5'000.00 lekë;
 - m) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në pikën 7 të nenit 12 dhe pikën 1 të nenit 13 të këtij ligji, subjekti dhe personi përgjegjës për zbatimin e punimeve dënohen me gjobë në masën 1000 lekë/m² (sipërfaqe bruto);
 - n) për moszbatim të detyrimeve të parashikuara në nenin 7 subjekti dhe personi përgjegjës për zbatimin e punimeve dënohen me gjobë në masën 1'000'000 lekë secili;
2. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, procesi i ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve të komisioneve të mbikqyrjes bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".
 3. Të ardhurat e realizuara nga zbatimi i masave administrative, sipas pikës 1, të këtij neni, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 35 **Ekzekutimi i vendimit**

1. Vendimi për kundërvajtjen administrative përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga shërbimi përmbartimor në rast se nuk shlyhet në kohë nga personi fizik ose juridik që ka kryer shkeljen.
2. Vendimi bëhet i ekzekutueshëm kur e drejta për ankim nuk është ushtruar brenda afateve kohore të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.
3. Të ardhurat që burojnë nga masat administrative derdhen në buxhetin e shtetit.

Neni 36 **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 1; 8, pika 16; 9, pika 1; 10, pika 6; 12, pika 4; 12, pika 7; 14, pika 7; 15, pika 18; 18, pika 3; 19, pika 5; 21, pika 6; 22, pika 7; 24, pika 4; 25, pika 1; 26, pika 2; 27, pika 4; 28, pika 1; 29, pika 1; dhe 30, pika 1; të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për energjinë që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10 pika 4; 20, pika 4; 26, pika 5; 27, pika 5; 29, pikat 5; 30, pika 3, dhe 32, pika 5, të këtij ligji.
3. Ngarkohet agjencia përgjegjëse për eficientimin e energjisë që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 33, pika 1 dhe 3 të këtij ligji.

Neni 37
Dispozita kalimtare

Aktet nënligjore që janë miratuar në përputhje me ligjin nr 116/2016, datë 10.11.2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” dhe aktet nënligjore që janë miratuar në përputhje me ligjin nr. 124/2015, “Për Efiçencën e Energjisë” i ndryshuar, qëndrojnë në fuqi nëse nuk bien ndesh me këtë ligj ose deri kur të zëvendësohen nga akte të tjera nënligjore respektivisht këtij ligji.

Neni 38
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 116/2016, datë 10.11.2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” shfuqizohet, si dhe dispozitat e parashikuara nga ligji nr. 124/2015, “Për Efiçencën e Energjisë” që bien ndesh me këtë ligj.

Neni 39
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

Shtojca I
Model për planet kombëtare të rinovimit të ndërtesave
(referuar në nenin 5)

Ky ligj Neni 3	Treguesit e detyrueshëm	Treguesit opsionalë
(a) Pasqyrë e stokut kombëtar të ndërtesave	Numri i ndërtesave dhe sipërfaqja e përgjithshme (m ²): — sipas llojit të ndërtesës (përfshirë ndërtesat publike dhe banesat sociale) — për klasën e performancës së energjisë — ndërtesa me energji pothuajse zero - ndërtesat me performancën më të keqe (duke përfshirë një përkufizim) — 43 % ndërtesat e banimit me performancën më të keqe — vlerësimi i pjesës së ndërtesave të përjashtuara në përputhje me nenin 9(6), pika (b)	Numri i ndërtesave dhe sipërfaqja e përgjithshme (m ²): — sipas moshës së ndërtimit - për madhësinë e ndërtesës - për zonë klimatike — prishja (numri dhe sipërfaqja totale e dyshemesë (m ²))
	Numri i certifikatave të performancës energjitike: - për llojin e ndërtesës (përfshirë ndërtesat publike) — për klasën e performancës së energjisë	Numri i certifikatave të performancës energjitike: - për periudhën e ndërtimit
	Normat vjetore të rinovimit: numri dhe sipërfaqja totale e dyshemesë (m ²) - sipas llojit të ndërtesës — në nivele ndërtesash me energji pothuajse zero dhe/ose me zero emetim — për thellësi rinovimi (rinovimi mesatar i ponderuar) - ndërtesat publike	
	Konsumi vjetor primar dhe final i energjisë (ktoe): - sipas llojit të ndërtesës - për përdorim përfundimtar Kursimet e energjisë (ktoe): - ndërtesa banimi - ndërtesa jo banesore - ndërtesat publike Përdorimi mesatar i energjisë primare në kWh/(m ² .y) për	Reduktimi i kostove të energjisë (EUR) për familje (mesatare) Përdorimi i energjisë parësore i një ndërtese që korrespondon me 15% më të lartë (pragu i kontributit të konsiderueshëm) dhe 30% më i lartë (pragu i mos dëmtimit të rëndësishëm) të stokut kombëtar të ndërtesave, sipas Rregullores së Deleguar (BE) 2021/2139 Pjesa e sistemit të ngrohjes në sektorin e

	<p>ndërtesat e banimit</p> <p>Pjesa e energjisë së rinovueshme në sektorin e ndërtesave (MW i instaluar ose GWh i prodhuar):</p> <ul style="list-style-type: none"> - për përdorime të ndryshme 	<p>ndërtesave sipas llojit të bojlerit/sistemit të ngrohjes</p> <p>Pjesa e energjisë së rinovueshme në sektorin e ndërtesave (MW i instaluar ose GWh i prodhuar):</p> <ul style="list-style-type: none"> - në vend - jashtë vendit
	<p>Emetimet operative vjetore të gazeve serrë (kgCO₂eq/(m².y):</p> <ul style="list-style-type: none"> - sipas llojit të ndërtesës <p>Reduktimi vjetor operacional i emetimit të gazeve serrë (kgCO₂eq/(m².y):</p> <ul style="list-style-type: none"> - sipas llojit të ndërtesës 	<p>GWP e ciklit jetësor (kgCO₂eq/m²) në ndërtesat e reja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - sipas llojit të ndërtesës
	<p>Barrierat dhe dështimet e tregut (përshkrim):</p> <ul style="list-style-type: none"> - stimuj të ndarë — kapaciteti i sektorit të ndërtimit dhe energjisë <p>Vlerësimi i kapaciteteve në sektorët e ndërtimit, eficiencës së energjisë dhe energjisë së rinovueshme</p>	<p>Barrierat dhe dështimet e tregut (përshkrim):</p> <ul style="list-style-type: none"> — administrative - financiare - teknike - ndërgjegjësimi - tjetër <p>Numri i:</p> <ul style="list-style-type: none"> — kompanitë e shërbimit të energjisë — kompanitë e ndërtimit - arkitektë dhe inxhinierë - punëtorë të kualifikuar - dyqane me një ndalesë — NVM-të në sektorin e ndërtimit/rinovimit — komunitetet e energjisë së rinovueshme dhe nismat e rinovimit të udhëhequra nga qytetarët <p>Parashikimet e fuqisë punëtore të ndërtimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> — arkitektë/inxhinierë/punëtorë të kualifikuar në pension — arkitektët/inxhinierët/punëtorët e kualifikuar që hyjnë në treg — të rinjtë në këtë sektor — gratë në sektor <p>Pasqyrë dhe parashikimi i evolucionit të çmimeve të materialeve të ndërtimit dhe zhvillimet e tregut kombëtar</p>
	<p>Varfëria energjitike (përkufizim):</p> <ul style="list-style-type: none"> — % e njerëzve të prekur nga 	

	<p>varfëria energjitike</p> <ul style="list-style-type: none"> — përqindja e të ardhurave të disponueshme familjare të shpenzuara për energji — popullata që jeton në kushte të papërshtatshme banimi (p.sh. çati që rrjedh) ose me kushte të papërshtatshme komforti termik 	
	<p>Faktorët kryesorë të energjisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> — për bartës të energjisë — faktori i energjisë primare jo të rinovueshme — faktori i energjisë primare të rinovueshme — faktori total i energjisë primare 	
	<p>Përkufizimi i ndërtesës me energji pothuajse zero për ndërtesat e reja dhe ekzistuese</p>	<p>Pasqyrë e kuadrit ligjor dhe administrativ</p>
	<p>Kërkesat e performancës minimale të energjisë me kosto optimale për ndërtesat e reja dhe ekzistuese</p>	
<p>(b) Udhërrëfyesi për 2030, 2040, 2050</p>	<p>Objektivat për normat vjetore të rinovimit: numri dhe sipërfaqja totale e dyshemesë (m²):</p> <ul style="list-style-type: none"> - sipas llojit të ndërtesës — ndërtesat me performancën më të keqe — 43 % ndërtesat e banimit me performancën më të keqe <p>Informacioni në përputhje me nenin 9(1):</p> <ul style="list-style-type: none"> — kriteret për të përjashtuar ndërtesat individuale jo-rezidenciale — pjesa e vlerësuar e ndërtesave jorezidenciale të përjashtuara — vlerësimi i përmirësimeve ekuivalente të performancës energjitike për shkak të ndërtesave jorezidenciale të përjashtuara 	<p>Objektivat për pjesën e pritshme (%) të ndërtesave të rinovuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> - sipas llojit të ndërtesës — sipas thellësisë së rinovimit
	<p>Objektivat për konsumin e pritshëm vjetor primar dhe final të energjisë (ktoe):</p> <ul style="list-style-type: none"> - sipas llojit të ndërtesës - për përdorim përfundimtar 	<p>Pjesa e energjisë nga burimet e rinovueshme në sektorin e ndërtimit (MW i instaluar ose GWh i prodhuar)</p>

	<p>Kursimet e pritshme të energjisë: - sipas llojit të ndërtesës</p> <p>Objektivat për rritjen e pjesës së energjisë së rinovueshme në përputhje me nenin 15a të Direktivës (BE) 2018/2001</p> <p>Objektivat numerike për vendosjen e energjisë diellore në ndërtesa</p>	
	<p>Objektivat për emetimet e pritshme operationale të gazeve serrë (kgCO₂eq/(m².y): - sipas llojit të ndërtesës</p> <p>Objektivat për reduktimin e pritshëm operational të emetimit të gazeve serrë (%): - sipas llojit të ndërtesës</p>	<p>Ndarja ndërmjet shkarkimeve të mbuluara nga Kapitulli III [instalimet stacionare], Kapitulli IVa [sistemi i tregtimit të emetimeve për ndërtesat, transporti rrugor dhe sektorë shtesë] të Direktivës 2003/87/EC, dhe stokut të tjerë;</p> <p>Objektivat për emetimin e pritshëm të gazeve serrë gjatë gjithë ciklit jetësor (kgCO₂eq/(m².y) në ndërtesat e reja: - sipas llojit të ndërtesës</p>
	<p>Përfitimet e pritshme më të gjera: — % ulje e njerëzve të prekur nga varfëria energjike</p>	<p>- Krijimi i vendeve të reja të punës — Rritja e PBB-së (pjesë dhe miliardë euro)</p>
	<p>Kontributi i shtetit anëtar në objektivat e Bashkimit për efikasitetin e energjisë në përputhje me nenin 4 të Direktivës (BE) 2023/1791 që i atribuohet rinovimit të stokut të ndërtesës së tij (pjesa dhe shifra në ktoe)</p>	
	<p>Kontributi i Shtetit Anëtar në objektivat e Bashkimit për energjinë e rinovueshme në përputhje me Direktivën (BE) 2018/2001 që i atribuohet rinovimit të stokut të ndërtesës së tij (aksioni, MW i instaluar ose GWh i prodhuar)</p>	
(c) Pasqyrë e politikave dhe masave të zbatuara dhe të planifikuara	<p>Politikat dhe masat në lidhje me elementët e mëposhtëm: (a) identifikimin e qasjeve me kosto efektive për rinovimin për lloje të ndryshme ndërtesash dhe zona klimatike, duke marrë parasysh pikat e mundshme të nxitjes në ciklin e jetës së ndërtesës;</p>	<p>Politikat dhe masat në lidhje me elementët e mëposhtëm: (a) rritja e qëndrueshmërisë klimatike të ndërtesave; (b) promovimin e tregut të shërbimeve të energjisë; (c) rritja e sigurisë nga zjarri; (d) rritjen e rezistencës ndaj rreziqeve nga fatkeqësitë, duke përfshirë rreziqet që</p>

<p>(b) standardet kombëtare të performancës minimale të energjisë në përputhje me nenin 9 dhe politikat dhe veprimet e tjera për të synuar segmentet me performancën më të keqe të stokut kombëtar të ndërtesave, duke përfshirë masat mbrojtëse të përmendura në nenin 17(19);</p> <p>(c) promovimi i rinovimit të thellë të ndërtesave, duke përfshirë rinovimin e thellë me faza;</p> <p>(d) fuqizimin dhe mbrojtjen e konsumatorëve vulnerabël dhe zbutjen e varfërisë energjitike, duke përfshirë politikat dhe masat në përputhje me nenin 24 të Direktivës (BE) 2023/1791, dhe përbalueshmërinë e banesave;</p> <p>(e) krijimin e dyqaneve me një ndalesë ose mekanizmave të ngjashëm në përputhje me nenin 18 për ofrimin e këshillave dhe asistencës teknike, administrative dhe financiare;</p> <p>(f) dekarbonizimi i ngrohjes dhe ftohjes, duke përfshirë rrjetet e ngrohjes dhe ftohjes qendrore, dhe heqjen graduale të lëndëve djegëse fosile në ngrohje dhe ftohje, me synim heqjen e plotë të kaldajave me lëndë djegëse fosile deri në vitin 2040;</p> <p>(g) parandalimin dhe trajtimin me cilësi të lartë të mbetjeve të ndërtimit dhe prishjes në përputhje me Direktivën 2008/98/EC, veçanërisht në lidhje me hierarkinë e mbetjeve dhe objektivat e ekonomisë rrethore;</p> <p>(h) promovimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në ndërtesa në përputhje me objektivin tregues për pjesën e energjisë nga burimet e rinovueshme në sektorin e ndërtimit të përcaktuar në nenin 15a(1) të Direktivës (BE)</p>	<p>lidhen me aktivitetin intensiv sizmik;</p> <p>(e) heqjen e substancave të rrezikshme duke përfshirë asbestin;</p> <p>(f) aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara;</p> <p>(g) rolin e komuniteteve të energjisë së rinovueshme dhe komuniteteve të energjisë së qytetarëve në qasjet e rretheve dhe lagjeve;</p> <p>(h) adresimi i mospërputhjeve në kapacitetet njerëzore; dhe</p> <p>(i) adresimi i përmirësimit të cilësisë së mjedisit të brendshëm.</p> <p>Për të gjitha politikat dhe masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> — burimet dhe kapacitetet administrative - zona(t) e mbuluara - me performancën më të keqe — standardet minimale të performancës së energjisë — varfëria energjitike, strehimi social - ndërtesat publike - banimi (një familje, shumë familje) - jo-rezidenciale — industria - burimet e rinovueshme të energjisë — heqja graduale e lëndëve djegëse fosile në ngrohje dhe ftohje — emetimet e gazeve serrë gjatë gjithë ciklit jetësor — ekonomi rrethore dhe mbetje - dyqane me një ndalesë — pasaportat e rinovimit — teknologjitë inteligjente — lëvizshmëri e qëndrueshme në ndërtesa — afrimet e rrethit dhe lagjes - aftësitë, trajnimi — fushatat ndërgjegjësuese dhe mjetet këshilluese
---	---

	<p>2018/2001;</p> <p>(i) vendosjen e instalimeve të energjisë diellore në ndërtesa;</p> <p>(j) reduktimin e emetimeve të gazeve serrë gjatë gjithë ciklit jetësor për ndërtimin, rinovimin, funksionimin dhe përfundimin e jetës së ndërtesave, dhe marrjen e largimit të karbonit;</p> <p>(k) promovimin e qasjeve të rretheve dhe lagjeve dhe programeve të integruara të rinovimit në nivel rrethi, të cilat mund të trajtojnë çështje të tilla si energjia, lëvizshmëria, infrastruktura e gjelbër, trajtimi i mbetjeve dhe ujërave dhe aspekte të tjera të planifikimit urban dhe mund të marrin parasysh burimet lokale dhe rajonale , rrethore dhe mjaftueshmëri;</p> <p>(l) përmirësimi i ndërtesave në pronësi të organeve publike, duke përfshirë politikat dhe masat në përputhje me nenet 5, 6 dhe 7 të Direktivës (BE) 2023/1791;</p> <p>(m) promovimin e teknologjive inteligjente dhe infrastrukturës për lëvizshmëri të qëndrueshme në ndërtesa;</p> <p>(n) adresimi i barrierave dhe dështimeve të tregut;</p> <p>(o) adresimi i boshllëqeve të aftësive dhe promovimi i arsimit, trajnimit të synuar, ngritjes së aftësive dhe rikualifikimit në sektorin e ndërtimit dhe efikasitetit të energjisë dhe sektorëve të energjisë së rinovueshme (qoftë publike apo private), me synimin për të siguruar që ka një fuqi punëtore të mjaftueshme me nivelin e duhur të aftësi që korrespondojnë me nevojat në sektorin e ndërtimit, me fokus të veçantë në grupet e nënpërfaqësuar;</p> <p>(p) fushata ndërgjegjësuese dhe</p>	
--	--	--

	<p>mjete të tjera këshilluese; dhe (q) promovimi i zgjidhjeve modulare dhe industriale për ndërtimin dhe rinovimin e ndërtesave.</p> <p>Për të gjitha politikat dhe masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> — emri i politikës ose masës — përshkrim i shkurtër (sfera e saktë, objektivi dhe kushtet e funksionimit) - objektivi sasior — lloji i politikës ose masës (si legislative; ekonomike; fiskale; trajnimi, ndërgjegjësimi) — buxheti i planifikuar dhe burimet e financimit — subjektet përgjegjëse për zbatimin e politikës - ndikimi i pritur — statusi i zbatimit - data e hyrjes në fuqi — periudha e zbatimit 	
(d) Përmbledhje e nevojave për investime, burimet buxhetore dhe burimet administrative	<ul style="list-style-type: none"> — Nevojat totale për investime për 2030, 2040, 2050 (milion euro) - investimet publike (milion euro) - investime private (milion euro) - burimet buxhetore 	
(e) Pragjet e ndërtesave të reja dhe të rinovuara me emetim zero, të përmendura në nenin 11	<ul style="list-style-type: none"> — pragjet operacionale të emetimeve të gazeve serrë të ndërtesave të reja me emetim zero; — pragjet operacionale të emetimeve të gazeve serrë të ndërtesave të rinovuara me emetim zero; — pragjet vjetore të përdorimit të energjisë primare të ndërtesave të reja me emetim zero; — pragjet vjetore të përdorimit të energjisë primare të ndërtesave të rinovuara me emetim zero 	
(f) Standardet minimale të performancës energjitike për ndërtesat jorezidenciale	<ul style="list-style-type: none"> — pragjet maksimale të performancës së energjisë, në përputhje me nenin 9(1) 	

(g) Trajektorja kombëtare për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave të banimit	— trajektorja kombëtare për rinovimin progresiv të stokut të ndërtesave të banimit, duke përfshirë piketat e 2030 dhe 2035 për përdorimin mesatar të energjisë primare në kWh/(m ² .y), në përputhje me nenin 9(2)	
--	---	--